

NATO

VËSHTRUAR NË MËNYRË TË PËRMBLEDHUR





Nisma për Edukim Euroatlantik
91, Vassil Levski Blvd., Sofia 1000,
Bulgaria
Tel./Fax: + 359 2 981 06 99
E-mail: eaei@abv.bg
www.eaei.org

Hartuar nga: Avgustina Tzvetkova
Anna Vassileva
Dessislava Hristova

Përkthyer në shqip nga: Këshilli Atlantik i Shqipërisë

Këshillues: Profesor Stiliyan Yotov
Dr. Arian Starova

ISBN 978-9543690-04-6

PËRMBAJTJA

Shënim redaksional	6
Parathënie nga Dr. Solomon Passy	7
Parathënie nga Z. Petrit Karabina, Zv Ministër i Mbrojtjes i Shqipërisë	8
Kur dhe ku u krijua NATO?	9
Parimet e rëndësishme të Traktatit të Atlantikut të Veriut	9
NATO e Lufta e Ftohtë	11
• NATO qysh prej viteve 1990	11
Përfytyrimi i sotëm mbi NATO-n	12
• Vlerat e përbashkëta.....	13
• Përmasat e sigurisë dhe Roli i ri i NATO-s	13
NATO në veprim	14
a. Procesi i vendimmarrjes - Parimi i konsensusit	14
b. Struktura politike	15
c. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s	16
d. Shtabi ndërkombëtar	16
e. Struktura ushtarake	17
f. Komandat ushtarake të NATO-s	17
g. Forcat e armatosura	18
Financimi i NATO-s	19
Asambleja Parlamentare	20
Shoqata e Traktatit të Atlantikut.....	20
Përmasat e Shndërrimit të NATO-s	21

Zgjerimi i NATO-s - Politika e Dyerve të Hapura	21
Misionet e Operacionet e NATO-s	22
a. Hapësira e përgjegjësive të NATO-s	22
b. NATO në Ballkan – Bosnja e Hercegovina, Kosova, Republika e Maqedonisë	22
c. NATO në Afganistan	24
d. Roli i NATO-s në Irak	25
Roli i NATO-s për Sigurinë Civile	25
Bashkëpunimi me Organizata të tjera ndërkombëtare	25
• OKB	26
• BE	27
• OSBE	28
NATO dhe Lufta kundër Terrorizmit	29
NATO dhe Rusia	30
NATO dhe Ukraina	31
Marrëdhëniet NATO - Shqipëri	32
• Paraqitje kronologjike	32
Përse është e nevojshme NATO? Zotimet e Përgjegjësive kryesore.	35
Pasthënie	37
Aneksë	38
• Traktati i Atlantikut të veriut	38
• NATO në akronime	41
• Tabela	45
- NATO në bashkëpunim me organizatat e tjera	45
- Partnerët e NATO-s	46
- Struktura politike	47
- Struktura civile e ushtarake	48

SHËNIM REDAKSIONAL

Kur u mendua për herë të parë idea e një udhërrëfyese *NATO vështruar në mënyrë të përmbledhur*, askush prej botuesve nuk priste që ky botim të ishte kaq i gjetur mirë në kohë. NATO është realitet i ri për Bullgarinë, ashtu si edhe për të gjithë vendet e Europës Qendrore e Lindore. Përpjekjet për të lartësuar Aleancën si mjete më premtues i garantimit të sigurisë nuk është aspak një detyrë e lehtë, megjithëse të ndihmshëm për përfytyrimin mbi NATO-n si mjete i duhur për dialog, bashkëpunim, demokraci, forcim të shtetit ligjor, rritje të qendrueshmërisë e respektimit të të drejtave e lirive vetiake provoi se ishte një prej arritjeve më sfiduese.

Në mënyrë të pagabueshme, pasuria më e vlefshme e jetës bashkëkohore është edukimi dhe mundësia për t'u informuar, rrugë që bëjnë të mundur të kuptohen ndikimet e gjera mbi çështjet e sigurisë e të politikës së jashtme brenda një mjedisi që ndryshon kaq shpejt dhe mënyra sesi çdokush të jetë i aftë të ndihmojë për një të ardhme më të mirë, duke u përpjekur për paqe, tolerancë e qendrueshmëri.

Pyetja se përse është i nevojshëm një botim i tillë nuk është më me vend. Tani është koha e duhur për të shkuar përpara në lidhje me mënyrën sesi t'i shumëfishojmë përfundimet pozitive në vende të tjerë të Europës Qendrore e Lindore – partnerë strategjikë të NATO-s e vendeve që kërkojnë të anëtarësohen në të.

E projektuar si ide fillestare për edukimin e edukuesve të shkollave të mesme të Bullgarisë, për t'i ndihmuar ata në misionin e tyre për t'u mësuar të rinjve vlerat euroatlantike, *NATO vështruar në mënyrë të përmbledhur* shkoj përtej synimeve të saj fillestare. Interesi që nxiti ky libër nëpërmjet përmbajtjes sfiduese e gjithëpërfshirëse si dhe mesazheve që bartëte në publikun e gjerë e bën shumë të rëndësishme shtrirjen e ndikimin e tij të mëtejshëm duke përparuar në këtë mënyrë në procesin e konkretizimit të rrugës drejt NATO-s e të zhvillimit të saj si Aleanca më e fuqishme e vendosur për të mbrojtur paqen e sigurinë në të gjithë botën.

Versionet e përkthimeve bullgarisht e anglisht të udhërrëfyesit tashmë janë në web site-n për edukimin të Shoqatës së Traktatit të Atlantikut në adresën www.ataedu.org. Botimi i tanishëm në shqip dhe botimet e mëvonshëm në gjuhët gjeorgjiane, ruse, serbe e ukrainase do të futen gjithashtu në web site-n e lartpërmendur.

Ky botim u bë i mundur nëpërmjet ndihmës metodike të dhënë nga Ministria e Edukimit dhe e Shkencës së Republikës së Bullgarisë, Shoqata e Mësuesve Bullgarë të Filozofisë, Komiteti i Edukimit i Shoqatës së Traktatit të Atlantikut, dhe Qendra e Informacionit e NATO-s në Sofia.

Botuesit e udhërrëfyesit *NATO... VESHTRUAR NE MENYRE TE PERMBLEDHUR* do të donin të shprehnin mirënjohjen e tyre ndaj Departmanenti të Diplomacisë Publike të NATO-s dhe Fondacionit *Hanns Seidel* për mbështetjen e ndihmën e tyre shumë të çmuar.

Për botimin e tanishëm dygjuhësh, në anglisht e shqip, si dhe përshtatjet e nevojshme në lidhje me përvojën e marrëdhënieve NATO-Shqipëri ndihmuan kolegët tanë të Këshillit Atlantik të Shqipërisë.

PARATHËNIE

Mund të duket si diçka e parëndësishme, por NATO është diçka reale, ashtu siç janë prozaikisht realë ajri, uji, zjarri, peisazhi dhe gjithshka që na rrethon. Pavarësisht prej kësaj, ose pikërisht për këtë arsye, ne kemi hulumtuar për të gjithë këto gjëra reale për më shumë se dhjetë vjet në shkollë nëpërmjet studimit të Kimisë, Fizikës, Gjeografisë dhe lëndëve të tjera mësimore. Tani, janë fëmijët tanë që hulumtojnë për to me qëllim që të jenë të aftë t'i përgjigjen ashtu si duhet realitetit në të cilin ata jetojnë, të dinjë se çfarë i kërcënon ata, të dine sesi të mbrojnë vetveten dhe sesi të mirëkujdesen që dukuritë e ndryshme t'i drejtojnë për të mirën e tyre.

Po iu drejtohem këtyre fakteve, sepse për fëmijët tanë, ashtu si edhe për të gjithë ne, NATO është një realitet i ri. Jo më shumë se pesëmbëdhjetë vjet më parë kjo organizatë vështrohej si armike nga vendi ynë dhe aleatët e Traktatit të Varshavës. Përballja ndërmjet dy superkoalicioneve ishte një gjendje lufte, fatmirësisht gjendje lufte "të ftohtë" e cila zgjati 40 vjet. Sot, pjesa më e madhe e ish anëtarëve të Traktatit të Varshavës janë anëtarë të NATO-s. Vendet e tjerë janë në procesin e një dialogu të dendur i cili tregon se kundërshtia ndërmjet tyre e NATO-s nuk është aspak burimi kryesor i acarimeve dhe paqëndrueshmërisë së botës së sotme.

Para 17 vjetësh, ka qenë Asambleja Kombëtare e Bullgarisë e cila për herë të parë në Europën Qendrore e Lindore nisi debatin për shpërbërjen e Traktatit të Varshavës e zgjerimin e NATO-s. Në atë kohë, askush nuk priste që bota do të përjetonte ankthin e 11 shatorit 2001.

Në ditët tona, megjithatë, shumë njerëz janë të vetëdijshëm që terrorizmi ndërkombëtar është kërcënimi kryesor i sigurisë dhe që NATO po ndryshon duke u bërë mjeti vendimtar në luftën kundër terrorizmit. Gjithashtu, Bullgaria është anëtar me të drejta të plota i NATO-s qysh prej dy vjetësh dhe si e tillë ajo luan një rol thelbësor në luftën kundër terrorizmit. Fjala "thelbësor" nuk është aspak e tepëruar: për shkak të parimit të konsensusit në procesin e vendimmarrjes së NATO-s, vendet më të vegjël kanë ndikim shumë të madh mbi vendet e tjerë, çka është shumë e pakrahasueshme me përmasat e tyre, popullsinë dhe fuqinë ushtarake. Kjo është arsyeja se përse anëtarësia e Bullgarisë në NATO nuk duhet të merret vetëm si një arsye për vetëbesim, por edhe si përgjegjësi që sjell detyrime. Ajo është përgjegjësi e cila mbështetet mbi të gjithë përfaqësuesit e shoqërisë dhe sidomos mbi brezin e ri të cilët janë në prag të jetës e karrierës së tyre.

Me këto pak ide, unë do të doja t'ua lehtësoj shqetësimet mësuësve e studentëve të Bullgarisë sipas të cilave programi shkollor do të rëndohej shumë dhe t'i siguroj ata se NATO nuk është vetëm një faktor i dobishëm por edhe interesant. Jam i bindur se ky udhërrëfyes që keni në dorë do të jetë një hartë e vlefshme që do t'ju udhëheqë nëpër momentet më kryesore të historisë, organizimit dhe funksionimit të Aleancës më të fuqishme politike e ushtarake të historisë së njerëzimit, të një Aleance të destinuar për të mbrojtur paqen botërore.

Gëzojeni botën e NATO-s!

Solomon Passy, Kryetar i Komitetit të Punëve të Jashtme të Asamblesë kombëtare të Bullgarisë. Minister i Punëve të Jashtme të Republikës së bullgarisë (2001-2005)

Sofia, 4 prill 2006.

PARATHËNIE

Është kënaqësi e veçantë për mua që më jepet mundësia të shprehem për këtë libër të përkthyer në gjuhën shqipe si dhe për përpimin e Shqipërisë në rrugën e saj drejt NATO-s. Vetë nisma e Klubit Atlantik të Bullgarisë për hartimin e këtij libri mbi NATO-n e përkthimin e tij në gjuhë të tjera ashtu si ky botim në gjuhën shqipe është shumë i lavdërueshëm dhe unë jam shumë mirënjohës që ky libër tani ndodhet në duart e shqiptarëve, e para së gjithash të të rinjve shqiptarë.

Anëtarësia në NATO dhe integrimi në BE janë objektiva përparësorë të Qeverisë shqiptare. Politika e jashtme e Shqipërisë, Siguria Kombëtare, bashkëpunimi rajonal e dypalësh, reforma në sektorin e sigurisë janë në përputhje me politikën e NATO-s dhe objektivat ushtarako-politikë të Partneritetit për Paqe.

Shqipëria ka dymbëdhjetë vjet që është pjesëmarrëse e Paetneritetit për Paqe, rrit bashkëpunimin me vendet anëtarë e partnerë të NATO-s, bën përpim në reformën në fushën e mbrojtjes, forcimin e institucioneve demokratike, rrit qendrueshmërinë politike e konomike të vendit dhe ka mbështetjen e gjerë të publikut për anëtarësimin në NATO.

Pjesmarrja në Procesin e Planifikimit e të Rishikimit (PARP), Programin Individual të Partneritetit (IPP) dhe në një numër mekanizmash të Partneritetit për Paqend e ka rritur ndërveprueshmërinë, sistemin e planifikimit të mbrojtjes si dhe standardet që duhet të plotësojë për t'u afruar me vendet anëtare e partnere të NATO-s.

Shqipëria është një pjestare vepruese në rajon dhe anëtare e një numri nismash të tilla si SEDM, A-3, Stability Pact, SEEC, SECI, RACVIAC, SEEC, etj. Ky bashkëpunim synon të krijojë një klimë rajonale të vullnetit të mire, zhvillimin e besimit të ndërsjelltë nëpërmjet veprimtarive të ndryshme, këshillimeve dhe arritjes së objektivave të përbashkët për vendet tona të rajonit.

Si një vend kërkues për t'u anëtarësuar në NATO, Shqipëria po punon që të plotësojë të gjithë objektivat që janë vendosur nga Aleanca perms Planit të Veprimit për Anëtarësim (MAP) në pesë fusha kryesore të tilla si politika, ekonomia, mbrojtja, legjislacioni dhe siguria e informacionit.

Rritja e aftësive për të marrë pjesë në operacionet e udhëhequr nga NATO ose BE siç janë ISAF, ose ALTHEA, si dhe për të marrë pjesë në koalicionin botëror kundër terrorizmit drejtpërdrejt me trupa në Irak e ka rryeshtuar Shqipërinë krahas forcave përparimtare demokratike, duke e bërë atë njëkohësisht të fitojë përvojë dhe rritë standardet për bashkëpunim me forcat ushtarake të vende perëndimorë.

Shqipëria po punon fort që të thellojë reformën me synimin që të meritojë ftesën për anëtarësim në NATO dhe të bëhet vend kontribues për paqen e sigurinë botërore.

Janë, pra, të paktën dy arsye madhore që e rritin vlerën e këtij botimi në gjuhën shqipe: roli i ri botëror i NATO-s dhe përpimimi e ndihmesa për sigurinë që realizon Shqipëria në rrugën e saj drejt NATO-s.

Petrit Karabina, Zv Ministër i Mbrojtjes i Shqipërisë

Tiranë, Shtator 2006

NATO ...

Vështruar në mënyrë të përmbledhur

1. Kur dhe ku u krijua NATO?

Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) u krijua më 4 prill 1949, me nënshkrimin e Traktatit të Atlantikut të Veriut nga dhjetë vende themelues europianë dhe dy amerikanoveriorë: Belgjika, Danimarka, Franca, Britania e Madhe, Islanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia e Portugalia si dhe Kanadaja e Shtetet e bashkuar të Amerikës.

Qëllimi kryesor i anëtarëve themelues ishte që t'i kundërviheshin rrezikut të zgjerimit të ndikimit të Bashkimit Sovjetik në Europë. Me nënshkrimin e këtij Traktati, anëtarët përkushtoheshin për të mbrojtur në mënyrë të ndërsjelltë lirinë e sigurinë e tyre me anën e mjeteve politike e ushtarake. Përfshirja e Amerikës së Veriut në mbrojtjen e Europës Perëndimore tregonte padyshim se çdo përpjekje për trysni politike ose ushtarake mbi Europën Perëndimore do të ishte e paracaktuar për dështim.

2. Parimet e rëndësishme të Traktatit të Atlantikut të Veriut

Funksionimi e qendrueshmëria e NATO-s mbështeten në radhë të parë mbi parimet themeluese të Traktatit të Atlantikut të Veriut, të cilët janë:

1. NATO **mbron lirinë e sigurinë e anëtarëve të saj** duke përdorur mjete politike e ushtarake në përputhje me qëllimet e parimet e kartës së OKB-së;
2. NATO është një **bashkim shtetesh që i lidhin vlerat e përbashkëta** tilla si demokracia, lirian vetiake dhe sundimi i ligjit dhe vendosmëria për t'i ruajtur këto vlera nga çdo dhunim;
3. Parimi vendimtar veprues i NATO-s është parimi i **mbrojtjes së përbashkët, të shprehur në nenin 5 të traktatit të Atlantikut**. Sipas tij, çdo sulm kundër njerit prej shteteve anëtarë mendohet si sulm kundër të gjithë aleatëve dhe prandaj kërkon veprime mbrojtëse të përbashkët;

4. NATO është një **forum ku të gjithë anëtarët këshillohen me njëri tjetrin dhe marrin vendime të përbashkët** në lidhje me çështjet e sigurisë të shteteve anëtarë;
5. NATO është një organizatë ndërqeveritare, brenda së cilës **shtetet anëtarë ruajnë sovranitetin e pavarësinë e tyre**;
6. NATO është **mishërim i lidhjes Transatlantike** që mban të paprekur sigurinë brenda Europës e Amerikës së veriut;
7. Traktati i Washingtonit mbron **parimin sipas të cilit bashkëpunimi politik është i papajtueshëm me praninë e konfliktëve ekonomike ndërmjet vendeve anëtarë**;
8. Mjetet me anën e të cilave NATO përpunon politikën e saj të sigurisë përfshijnë **zhvillimin e mbajtjen e vazhdueshme të aftësive ushtarake vetiake e të përbashkëta të shteteve anëtarë**;
9. Aleanca **mbetet e hapur për anëtarë të rinj**. Këta duhet të jenë vende që kanë vullnet e janë të aftë të ndihmojnë për sigurinë e hapësirës së Atlantikut të Veriut dhe anëtarësimin e të cilëve e mbështetin në mënyrë të njëzëshme të gjithë vendet anëtarë.

3. NATO e Lufta e Ftohtë

Përfundimi i Luftës së Dytë Botërore shënoi ndarjen e Europës Lindore e Perëndimore sipas vijave politike e ideologjike.

Ndërmjet viteve 1947 e 1952, Plani i Ndhmës Marshall dha burime shumë të mëdha për rindërtimin e qendrueshmërinë e ekonomive të Europës Perëndimore të shkatërruara nga lufta. Ndërkohë, NATO kishte lindur si një garantuese e mbrojtjes së përbashkët kundër çdo lloj agresioni dhe si një mbrojtëse e zhvillimit të demokracisë dhe rritjes ekonomike. Sipas fjalëve të Presidentit të Sh.B.A.-së të asaj kohë, Harry Truman, Plani Marshall dhe NATO ishin *dy gjysma të së njëjtës guackë mbrojtëse*.

Në fillim të viteve 1950, gjendja ndërkombëtare dhe kulmi i Luftës së Koresë ripohuan rreziqet e frikën për politikën e ambicjet ekspansioniste të Bashkimit Sovjetik. Ky fakt i nxiti të gjithë vendet anëtarë të NATO-s që të dyfishojnë përpjekjet e tyre për forcimin e strukturave ushtarake të nevojshme për mbrojtjen e përbashkët. Prania e forcave ushtarake amerikane në territorin evropian, të cilat u vendosën pas kërkesës së qeverive europiane e çuan Bashkimin Sovjetik në përfundimin se çdo aggression nga ana e tij nuk do të ishte i suksesshëm.

Gjithashtu, NATO u bë një faktor tërheqës edhe për vende të tjerë të cilët iu bashkuan Aleancës – Greqia e Turqia, në vitin 1952. Republika Federale e Gjermanisë, në vitin 1955, kurse Spanja, në vitin 1982. falë pranisë vepruese të NATO-s në skenën botërore, Europa Perëndimore dhe Amerika e veriut jo vetëm e mbrojtën në mënyrë

të ndërsjelltë pavarësinë e tyre por arritën edhe një nivel të paparë qendrushmërie e cila krijoi themelin për bashkëpunim e integrimin ekonomik të Europës. Qendrushmëria ekonomike e Europës dhe bashkëpunimi transatlantik shërbyen edhe si parakushte për përfundimin e Luftës së Ftohtë si dhe për kapërcimin e ndarjes së Europës.

4. NATO pas përfundimit të Luftës së Ftohtë

Me përfundimin e Luftës së Ftohtë dhe të kundërvënies së blloqeve Perëndimore e Lindore, arsëyet për të cilat NATO ishte krijuar nuk ekzistonin më. Natyra e sfidave bashkëkohore të sigurisë ndryshoi, gjithashtu, në mënyrë të rëndësishme. Pavarësisht prej skepticizmit në lidhje me të ardhmen e NATO-s, kjo e fundit jo vetëm vazhdoi të qëndrojë gjatë gjithë periudhës së përfundimit të Luftës së Ftohtë, por edhe provoi se ishte njëra prej organizatave ndërkombëtare moderne më të frytëshme në fushën e sigurisë, anëtarët e partnerët e së cilës vazhdimisht shtoheshin në numër.

• NATO qysh prej viteve 1990

Vitet 1990 u shënuan nga një varg ngjarjesh të rëndësishme. Në vitin 1990, për herë të parë, NATO-ja i ofroi bashkëpunim Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjerë europianë që nuk ishin anëtarë. Kjo ndodhi gjatë sesionit të Këshillit të Atlantikut Verior, në qershor, në Turnburry të Skocisë, në kohën kur Ministrat e Punëve të Jashtme të shteteve anëtarë shpallën të ashtuaquajturin *Mesazh prej Turnburry-it*. Një muaj më vonë, në Londër, Kryetarët e Shteteve dhe udhëheqja e NATO-s nënshkruan *Deklaratën e Londrës*, në të cilën aleatët shfaqën vullnet e vendosmëri për shndërrimin e Aleancës. Kjo deklaratë përbëhej nga propozime të ndryshëm për krijimin e një bashkëpunimi të gjerë me vendet e Europës Qendrore e Lindore në fushat politike e ushtarake, si dhe për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike zyrtare.

Vitin më pasëm, në fillim të nëntorit, Kryetarët e Shteteve dhe udhëheqja e NATO-s shpallën *Deklaratën e Romës për Paqe e Bashkëpunim*, e cila propozonte institucionalizimin e marrëdhënieve e të bashkëpunimit me ish Bashkimin Sovjetik dhe vendet e Europës Qendrore e Lindore në lidhje me çështjet politike e të sigurisë. Kjo Deklaratë hidhte edhe themelet e krijimit të Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut Verior (NACC), ku Bullgaria ishte anëtar themelues. Mbledhja e parë e Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut Verior u zhvillua në dhjetor 1991. Arritje e rëndësishme e këtij sesiioni ishte miratimi i Deklaratës për Dialogun, Partneritetin dhe Bashkëpunimin.

Mbledhja e Nivelit të lartë e Brukselit, në fillim të vitit 1994, shënoi marrjen e nismës për rritjen e sigurisë e të qendrushmërisë në të gjithë Europën, të njohur si

Partneriteti për Paqe (PfP). Vendet partnerë të Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut Verior dhe shtetet e Konferencës për Siguri e Bashkëpunim në Europë, të organizatës që në të ardhmen do të bëhej OSBE, u ftuan që të bëheshin pjestarë të PfP-së.

Në vitin 1997, në Sintra të Portugalisë, NACC-i u zëvendësua nga **Këshilli i Partneritetit Euroatlantik**, qëllimi kryesor i të cilit ishte që të hapte një faze të re për bashkëpunimin transatlantik.

Në Mbledhjen e Nivelit të lartë të **Madridit**, të mbajtur në të njejtin vit, udhëheqësit njoftuan kalimin në një periudhë të re të zhvillimit të NATO-s. Republika Çeke, Hungaria e Polonia u ftuan për të filluar bisedimet zyrtare për anëtarësim në NATO. U ripërcaktuan marrëdhëniet me Rusinë dhe u krijuan zyrtarisht themelet për partneritetin me Ukrainën.

Në prill të vitit 1999, **Washingtoni** u bë vendi pritës i Mbledhjes së Nivelit të lartë të 15 të NATO-s, e cila shënonte edhe përvjetorin e 50 të Aleancës. Në këtë sesion, Republika Çeke, Hungaria e Polonia u mirëpritën si anëtarë të NATO-s. Kjo Mbledhje mori nisma të reja me rëndësi strategjike të tilla si, Plani i Veprimit për Anëtarësim, që synonte të ndihmonte vendet që dëshëronin të bëheshin anëtarë. Kjo Mbledhje ka qenë e shquar edhe për përcaktimin e Konceptit të Ri Strategjik të NATO-s, i cili përshkruante mjedisin e sigurisë që po ndryshonte dhe ideonte rolin e ri të NATO-s në sigurinë botërore të shekullit 21.

Mbledhja tjetër e Nivelit të Lartë të NATO-s u zhvillua në **Pragë**, në nëntor të vitit 2002. Në këtë Mbledhje, Bullgaria, Estonia, Letonia, Lituania, Rumania, Sllovakia e Sllovenia u ftuan zyrtarisht që të fillojnë bisedimet për anëtarësimin e tyre në NATO. Kjo Mbledhje krijoi *Përkushtimin e Pragës për Aftësitë* në përpjekje për t'u ballafaquar me terrorizmin ndërkombëtar dhe për të marrë vendime në lidhje me shndërrimin e aftësive ushtarake të Aleancës.

Mbledhja më e fundit e Nivelit të Lartë të NATO-s e cila kishte rëndësi strategjike u zhvillua në **Stamboll**, në qershor të vitit 2004. Në këtë sesion Aleanca mirëpriti si anëtarë të rinj shtatë vende, përfshirë Bullgarinë. Kështu, **numri i përgjithshëm i shteteve anëtarë të NATO-s arriti në 26**. Përveç procesit të zgjerimit, Aleanca u përqendrua edhe në përparimin me partneritete në rajone përparësore si Kaukazi i Jugut dhe Azia Qendrore. Njëkohësisht, kjo Mbledhje mori vendime në lidhje me rritjen e Dialogut me me 7 vendet partnere mesdhetare si dhe mori një nismën të re me shtete prej të ashtuquajturës Lindje e Mesme e zgjeruar.

1. Përfytyrimi i sotëm mbi NATO-n

Tani, NATO është një organizatë që ndryshon shumë prej asaj që u krijua në vitin 1949. aleanca nuk është as ajo garantoj mbrojtjen e Europës Perëndimore për

më shumë se katër dhjetëvjeçarë gjatë Luftës së Ftohtë, as ajo që vëzhgonte proceset e tranzicionit në Europë, në fillim të viteve 1990. Zhvillimi i NATO-s nuk është aspak një rastësi. Faktori vendimtar i suksesit të NATO-s qëndron në aftësinë ripërtëritëse të vlerave të saj, dmth, në terrenin e fortë mbi të cilin ajo ishte ngritur dhe mbi të cilin zhvillohej.

• Vlerat e përbashkëta

NATO nuk është vetëm një aleancë për mbrojtje të përbashkët, por edhe një tërësi **vlerash të përbashkëta**. Duke mbajtur parasysh natyrën e ndryshueshme të kërcënimeve botërore të sigurisë, për të gjithë shtetet anëtarë vlerat e demokracisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe sundimi i ligjit janë provuar si të besueshme.

Gjithashtu, NATO është garantues i realizueshmërisë së përmasës transatlantike të përpjekjeve për t'u përballur me sfidat botërore të sigurisë. Aleanca lidh Europën me Amerikën e Veriut dhe shërben si themel për barazpeshën ndërmjet interesave të ndryshëm kombëtarë në emër të paqes e qendrueshmërisë së përbashkët.

• Përmasat e sigurisë dhe Roli i ri i NATO-s

Gjatë Luftës së Ftohtë, përgjegjësitë kryesore të NATO-s kanë qenë qartësisht të lidhura me mbrojtjen e anëtarëve të saj prej kërcënimit ekspansionist Sovjetik. Me shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik, kundërshtari tradicional i aleancës u zhduk, duke çuar drejt ripërcaktimit të mjedisit të sigurisë dhe të objektivave të Aleancës.

Koncepti i Ri Strategjik i NATO-s, i krijuar në vitin 1999, i njehsonte rreziqet botërore të sigurisë si të gjithanshme e të vështira për t'u parashikuar. Detyrat thelbësore të Aleancës u ideuan si vijon:

1. Të shërbejë si themel për qendrueshmërinë e hapësirës euroatlantike;
2. Të shërbejë si forum për këshillime mbi çështjet e sigurisë;
3. Të veprojë si kufizues e mbrojtës kundër çdo kërcënimi për agresion ndaj secilit prej shteteve anëtarë;
4. Të ndihmojë për parandalim veprues ndaj konflikteve dhe mirëkujdesje për krizat;
5. Të mbajë marrëdhënie partneriteti e dialogu me vendet e hapësirës euroatlantike.

Koncepti Strategjik i Aleancës shpallte gjithashtu se natyra e mjedisit të sigurisë po ndryshon edhe në një anë pozitive. Njëkohësisht, megjithatë, shtetet po përballeshin me rreziqe të ndryshëm dhe burime të tillë paqendrueshmërie si konfliktet etnike, dhunimi i të drejtave të njeriut, pasiguria politike dhe kriza ekonomike. Mbi të

gjitha, shqetësim serioz ishte përhapja e armëve bërthamore, biologjike e kimike. Edhe zhvillimi i teknologjisë së informacionit krijonte rrezik të mundshëm për sigurinë, meqenëse ajo shërbente si mjet për t'u dhënë informacion grupeve armiq.

Në vitet që erdhën pas vitit 1999, sidomos pas sulmeve terroriste mbi Sh.B.A. të 11 shtatorit 2001, NATO ripohoi rreziqet e kërcënimit terroriste botërore që vinin prej shteteve të dobët dhe i vuri këta shtete në krye të përparësive të sigurisë.

6. NATO në veprim

NATO është një organizatë ndërqeveritare, një aleancë shtetesh sovranë, e bashkuar në emër të sigurisë dhe vlerave të përbashkëta. NATO merr vendime duke u mbështetur në parimin e konsensusit.

Zyrat Qendrore të NATO-s ndodhen në Bruksel. Atje ndodhet selia e përhershme e Këshillit të Atlantikut të Veriut (NAC). Në të bëjnë pjesë delegacionet kombëtare të shteteve anëtarë, Sekretari i Përgjithshëm dhe Shtabi Ndërkombëtar, Kryetari i Komitetit Ushtarak dhe Shtabi Ushtarak Ndërkombëtar, Misionet Diplomatike të shteteve partnerë dhe agjenci të ndryshme të NATO-s.

Shtetet anëtarë kanë delegacione të përhershme në Zyrtat Qendrore të NATO-s, që udhëhiqen nga krerët e misioneve. Çdo shtet anëtar përfaqsohet edhe nga një delegat ushtarak. Përfaqesuesi i përhershëm, ashtu si edhe ushtarakët, ndihmohen për kryerjen e detyrave të tyre nga një grup këshilltarësh e oficerësh civilë e ushtarakë të cilët përfaqsojnë vendim përkatës në secilin prej Komiteteve të NATO-s. Fakti që delegacionet kombëtarë qëndrojnë e punojnë së bashku në Zyrtat Qendrore të NATO-s i lehtëson marrëdhëniet zyrtare e jozyrtare ndërmjet tyre, po ashtu si edhe ndërveprimet e tyre me vendet partnerë dhe me oficerët e Shtabit Ndërkombëtar.

NATO është e organizuar mbi stuktura politike e ushtarake, të cilat merren, respektivisht, me anët politike e ushtarake të veprimtarive të NATO-s. secila prej këtyre strukturave ndihmon njësitë vendimmarrëse, prej të cilave njësia më e lartë është Këshilli i Atlantikut Verior.

a. Procesi i vendimmarrjes – Parimi i konsensusit

Një prej elementëve kyç për kuptimin e realizueshmërisë së NATO-s është të kuptuarit e natyrës dhe veçorive të procesit të vendimmarrjes, që mbështetet mbi **parimin e konsensusit**. Arritja e një marrëveshjeje ndërmjet të gjithë shteteve anëtarë të Aleancës shpesh është një proces i vështirë e që kërkon kohë. Kjo është arsyeja se përse, përpara marrjes së një vendimi përfundimtar, sidomos për çështje të rëndësishme, është e nevojshme të bëhen bisedime e këshillime të vazhdueshme.

Duke mbajtur parasysh këtë proces të gjatë bisedimesh, mund të duket sikur sistemi i vendimmarrjes i NATO-s është shumë i ndërlikuar e i ngathët. Megjithatë, ai e ka provuar frytshmërinë e tij dhe përparësitë e padiskutueshme gjatë viteve. Të mirat e tij më të spikatura janë:

E para, parimi i konsensusit e lejon këtë organizatë që të respektojë sovranitetin e pavarësinë e shteteve anëtarë si dhe të mbajë parasysh interesat e tyre kombëtarë në çdo rast shqetësues.

E dyta, ky parim i jep vendimeve të NATO-s shkallën më të lartë të legjitimitetit politik. Konsensusi është garancia që çdo veprim të mbështetet nga të gjithë shtetet anëtarë, të cilët, duke dhënë pëlqimin e tyre, përkushtohen ndaj zbatimit të vendimeve.

b. Struktura politike

Institucionet kryesore drejtuese të NATO-s, të cilat formësojnë politikën e strategjinë e Aleancës në të gjitha veprimtaritë e saj, janë **Këshilli i Atlantikut Verior (NAC)**, **Komiteti i Planifikimit të Mbrojtjes (DPC)** dhe **Grupi i Planifikimit Bërthamor (NPG)**.

Këshilli i Atlantikut Verior është njësi vendimmarrëse me rëndësi vendimtare për Aleancën. Ky Këshill është njësi politike që përbëhet nga përfaqësues të të gjithë shteteve anëtarë. Ai vepron në nivele të ndryshëm: së paku një herë në javë bëhet një mbledhje e ambasadorëve; të paktën dy herë në vit atje mblidhen të gjithë Ministrat e Jashtëm ose Ministrat e Mbrojtjes dhe, nëse është e nevojshme, ky Këshill mblidh edhe Kryetarët e Shteteve.

Pavarësisht prej nivelit të veprimit të këtij Këshilli, fuqia për të marrë vendime, si dhe statusi i këtyre vendimeve dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre, janë të njejtë. Zakonisht, ky Këshill diskuton për çështje që kanë interes të përbashkët dhe të tilla që kërkojnë veprime të veçantë, pa i kufizuar çështjet që diskutohen.

Komiteti i Planifikimit të Mbrojtjes merret kryesisht me çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e përbashkët. Ai i jep udhëzime Komandës Ushtarake të NATO-s dhe ka të njejtin autoritet si edhe Këshilli i Atlantikut Verior për çështje që kanë të bëjnë me të drejtat e përgjegjësitë e tij. Ky komitet zakonisht i bën mbledhjet e tij në nivel ambasadorësh, por dy herë në vit, ai mblidh edhe Ministrat e Mbrojtjes.

Ministrot e Mbrojtjes të shteteve anëtarë takohen rregullisht brenda **Grupit të Planifikimit Bërthamor**. Ky grup merret me një tërësi të gjerë çështjesh politike që lidhen me politikën bërthamore, të tilla si vendosja e forcave bërthamore, siguria,

ruajtja e kontrolli i armëve bërthamore, sistemet e komunikacionit e të informacionit dhe përhapja e armëve bërthamore.

Franca nuk është anëtare e strukture ushtarake të integruar dhe për këtë arsye nuk merr pjesë as në mbledhjet e Komitetit të Planifikimit të Mbrojtjes as në ato të Grupit të Planifikimit Bërthamor.

Si Komiteti edhe Grupi për të cilët po flasim mbikqyrin një numër komitetesh të tjerë, siç janë Komiteti Politik, Komiteti i Rishikimit të Mbrojtjes, Komiteti Ekonomik, Komiteti i NATO-s për Infrastrukturën, etj. këta grupe merren me anë të veçanta të përgjegjësive të NATO-s në fushat politike, ushtarake dhe ekonomike.

Veprimtaritë e përbashkëta të NATO-s me vendet e saj partnere janë gjithashtu subjekt i këshillimeve të vazhdueshme me përfaqësuesit e shteteve partnerë. Këto bisedime bëhen në forume të veçantë, të tillë si Këshilli i Partneritetit Euroatlantik, Këshilli NATO-Rusi, Komisioni NATO-Ukrainë dhe Grupi i Bashkëpunimit Mesdhetar.

c. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s është një zyrtar ndërkombëtar i nivelit të lartë, që emërohet nga vendet anëtarë. Ai/ajo kanë për detyrë që të japin udhëzimet për këshillimet dhe proceset e vendimmarrjes në NATO. Sekretari i Përgjithshëm shërben edhe si Kryetar i Këshillit të Atlantikut Verior dhe i komiteteve të tjerë të lartë. Ai/ajo ka të drejtë të bëjë propozime për të vënë në rendin e ditës të vendimmarrjes çështje të veçanta. Ai/ajo mund të luajë edhe rolin e një kryetari të paanshëm e të pavarur dhe të udhëheqë bisedime drejt konsensusit, duke vepruar në emër të interesave të përbashkët të Aleancës. Sekretari i Përgjithshëm nuk ka fuqi që të marrë vendime në mënyrë të njëanëshme, por ai mund të veprojë në emër të kësaj Organizate në masën që ai/ajo është i autorizuar nga qeveritë e shteteve anëtarë. Sekretari i Përgjithshëm i Aleancës është edhe zëdhënësi kryesor i kësaj Organizate dhe kreu i Shtabit ndërkombëtar.

d. Shtabi Ndërkombëtar

Shtabi Ndërkombëtar mbështet Këshillin e Atlantikut Verior dhe i nënshtrohet komiteteve gjatë ushtrimit të detyrave të tij. Anëtarët e tij janë përfaqësues të shteteve anëtarë, të punësuar nga NATO ose të emëruar nga autoriteti kombëtar përgjegjës për një periudhë 3-4 vjet. Anëtarët e Shtabit Ndërkombëtar i nënshtrohen drejtpërsëdrejti Sekretarit të Përgjithshëm dhe kanë përgjegjësinë që të jenë besnikë ndaj kësaj Organizate gjatë gjithë periudhës së qëndrimit në detyrë.

Qysh prej krijimit në vitin 1951, struktura e Shtabit ndërkombëtar ka ndryshuar shumë herë. Ndryshimet më të fundit u bënë në vitin 2003 dhe si rrjedhojë ky institucion tani përfshin Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, Zyrën e NATO-s për Sigurinë dhe gjashtë drejtori, secila e kryesuar nga një Ndihmës Sekretar i Përgjithshëm.

e. Struktura ushtarake

Struktura ushtarake e NATO-s i nënshtrohet **Komiteti Ushtarak**. Komiteti Ushtarak është njësia e nivelit më të lartë brenda Aleancës, por mbetet ende nën udhëheqjen politike të Këshillit të Atlanikut Verior. Në mbledhjet e nivelit të lartë marrin pjesë Shefat e Shtabeve të Përgjithshëm, kurse në mbledhjet e përditëshme marrin pjesë përfaqësuesit ushtarakë të vendeve anëtarë. Ky komitet jep udhëzime për strukturat politike të NATO-s në lidhje me strategjinë ushtarake dhe ka për detyrë të zbatimit të përgjithshëm të veprimtarive ushtarake të Aleancës.

Kryetari i Komitetit Ushtarak (CMC) zgjidhet nga Shefat e Shtabeve dhe caktohet për një periudhë trevjeçare. Ai vepron vetëm në cilësinë e tij si përfaqësues ndërkombëtar dhe autoriteti i tij buron nga Komiteti ushtarak, ndaj të cilit ai është përgjegjës për kryerjen e detyrave të veta. Mbledhjet e Komitetit Ushtarak i drejton të gjitha ai zakonisht.

Kryetari i Komitetit Ushtarak është edhe zëdhënës edhe përfaqësues. Ai drejton punën e tij të përditëshme dhe vepron në emër të Komitetit për nxjerrjen e udhëzimeve të nevojshme dhe orientimeve për Drejtorin e Shtabit Ushtarak Ndërkombëtar.

Komiteti Ushtarak ndihmohet nga **Sekretariati Ushtarak Ndërkombëtar**, i cili përbëhet nga zyrtarë ushtarakë që përfaqësojnë shtetet anëtarë në Zyrat Qendrore të NATO-s.

Komiteti ushtarak jep udhëzime për Komandat Ushtarake të NATO-s.

f. Komandat Ushtarake të NATO-s

Janë dy komanda ushtarake të NATO-s të cilat kanë rëndësi strategjike. Njera është Komanda Supreme e Aleatëve për Europën (SACEUR), e cila e ka selinë e vet në Mons të Belgjikës. Tjetra është Komanda Supreme e Aleatëve për Shndërrimin (SACT) e cila e ka selinë në Norfolk, të shtetit Virginia të Sh.B.A.-së.

SACEUR është kreu i Komandës së Aleatëve për Operacionet (ACO) e cila mbikqyr zhvendosjen e forcave nga aleatët. SACEUR ka për detyrë të kujdeset për të gjithë operacionet tokësore të NATO-s, pavarësisht prej vendit se ku vendosen ato dhe ajo është edhe Kryesuese e Komandës Europiane të Sh.B.A.-së.

Roli i SACT-it është kryesisht veprues. Si kryesues i Komandës së Aleatëve për Shndërrimin (ACT), ai ka për detyrë të kujdeset për forcimin e kontrollin e procesit të vazhdueshëm të shndërrimit të aftësive ushtarake të Aleancës. Ai ka një përgjegjësi të dyfishtë, meqenëse është edhe Komandë e forcave të bashkuara të Sh.B.A.-së.

Më pare, ndarja e përgjegjësive të të dy komandave mbështetej në parimin gjeografik: SACEUR kishte në ngarkim operacionet e NATO-s në Europë, kurse komanda Supreme e Aleatëve për Atlantikun (SACLANT) ishte përgjegjës për operacionet në hapësirën atlantike. Ristrukturimi i komandës u miratua në Mbledhjen e Nivelit të Lartë të Pragës, në nëntor 1992. Ndryshimi i përgjegjësive ishte shfaqje e përkushtimit të NATO-s për zhvillimin e aftësive të saj mbrojtëse dhe të gatishmërisë së saj për të marrë pjesë gjallërisht në operacione.

g. Forcat e Armatosura

Idea e “forcave të NATO-s” mund të ishte mashtruese për ata që nuk njihen nga afër me natyrën e kësaj organizate. Në të vërtetë, Aleanca nuk ka forca ushtarake nga pikpamja e të qenit të përherëshme. Çdo vend anëtar që është pjesë e strukturës ushtarake të NATO-s është i përkushtuar që të jape një numër të caktuar e një lloj të caktuar forcash ushtarake për realizimin e detyrave e operacioneve për të cilat është biseduar zyrtarisht.

Si rregull, pjesa më madhe e forcave të NATO-s qëndrojnë nën komandën e tyre kombëtare gjatë gjithë kohës që kryejnë detyrat e caktuara nga NATO në përputhje me kërkesat e një operacioni të caktuar. Përjashtime të vetme nga ky parim janë Shefat e Shtabit të Integruar dhe forcat operacionale të tilla si Forcat e Paralajmërimit të Hershëm, Kontrolli Ajror dhe Forcat Detare të Përherëshme.

Qysh prej fillimit të NATO-s, detyra kryesore e forcave të armatosura ka qenë garantimi i sigurisë e tërësisë tokësore të shteteve anëtarë. Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, megjithatë, roli i forcave të armatosura u shndërrua tërësisht si rrjedhojë e mjedisit të shndërruar të sigurisë brenda hapësirës transatlantike.

Ndryshimet e forcave të armatosura të NATO-s në periudhën e Pasluftës së Ftohtë kanë qenë sasiore e cilësore. Disa prej tyre tashmë janë bërë, ndërkohë që të tjerat mbeten ende për t’u bërë.

Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, numri i përgjithshëm i forcave të armatosura u pakësua shumë. Në mënyrë më të veçantë, qysh prej fillimit të viteve 1990, personeli i forcave tokësore të shteteve anëtarë që ndodhet në zotërim të NATO-s u shkurtua me 35%; numri i anijeve të forces detare me 30% kurse skuadrat e luftimit të forcave ajrore me rreth 4%. Pjesa më e madhe e forcave nuk janë më në gjendje

gatishmërie të lartë dhe janë ristrukturuar me synim që të rritet zhdërvjelltësia, lëvizshmëria e ndërveprueshmëria e tyre.

Në Mbledhjen e Nivelit të Lartë të Pragës, të mbajtur në 21022 nëntor 2002, u ndërmorën tri nisma me rëndësi shumë të madhe për shndërrimin ushtarak, të cilat luajtën një rol vendimtar në përshtatjen e aftësive ushtarake të NATO-s:

1. **Krijimi i Forcës së Kundërpërgjigjes të NATO-s (NRF).** Këto forca, që arrijnë në rreth 22 000, përbëhen nga pjesë përbërëse tokësore, ajrore e detare të gatshme për t'u vendosur në më pak se pesë ditë. Ceremonia përuaruese e krijimit të NRF-s u bë më 15 tetor 2003 në Brunsum të Holanda. Veprueshmëria e plotë e këtyre forcave duhet të rritet jo më vonë se tetori i vitit 2006.
2. Brenda të ashtuauqjiturit **Përkushtimi i Pragës për Aftësitë**, aleatët e NATO-s marrin përkushtime politike vetiake për përmirësimin e zhvillimin e aftësive të tyre mbrojtëse kombëtare në një larmi të gjerë fushash.
3. **Racionalizimi i Strukturës së Komandës së Aleatëve.** Komandat Strategjike për Europën dhe Atlantikun u shndërruan në Komandën Strategjike për Operacionet dhe Komandën Strategjike për Shndërrimet. Numri i komandave rajonale e vartëse u pakësua (nga 20 në 11) dhe u optimizua.

7. Financimi i NATO-s

Buxheti i NATO-s ndërtohet nëpërmjet pagesave vjetore të shteteve anëtarë, shumata e të cilit përcaktohet sipas një formule për ndarjen e shpenzimeve të miratuara nga aleatët. Praktikisht, pagesat e anëtarësisë janë pjesë e buxhetit të mbrojtjes të çdo vendi.

Buxheti i financuar bashkarisht shpërndahet ndërmjet një buxheti që përbëhet nga pjesa civile, ushtarake e ajo infrastrukturore e financuar bashkarisht.

Buxheti civil mbulon shpenzimet e funksionimit për Shtabin Ndërkombëtar, programet e veprimtaritë civile, si dhe shpenzimet e nevojshme për përdorimin e mirëmbajtjen e teknike të pajisjeve të tilla si pajisjet e konferencave të përdorura për mbledhjet e komiteteve dhe të grupeve të punës.

Buxheti ushtarak mbulon shpenzimet e funksionimit e të mirëmbajtjes së strukturës ushtarake të integruar, përfshirë Komitetin Ushtarak, Shtabin Ushtarak ndërkombëtar dhe agjencitë e lidhura me to, dy Komandat Strategjike dhe sistemet e lidhur të komandës e kontrollit si dhe sistemet e informacionit, agjencitë Kërkimore e të Zhvillimit dhe ato që merren me furnizimin e logjistikën e AWACS-ët.

Programi i Investimeve për Sigurinë i NATO-s (NSIP) jep fonde për projekte që lidhen me infrastrukturën ushtarake të shteteve anëtarë të NATO-s. Disa synime të prjekteve të veçantë përfshijnë sistemet e informacionit e të komunikacionit, radarët, qendrat e komandës e të kontrollit, aeroportet, tubacionet, depot dhe pajisjet e porteve. Të gjithë aleatët janë anëtarë të NSIP-it edhe në mungesë. Përjashtim të vetëm nga rregulli përbën Franca e cila nuk është anëtare e strukturës ushtarake të integruar.

Buxhetet e lartpërmendur janë nën mbikqyrjen e Komiteteve të Buxhetit Civil e Ushtarak, Komitetit të Infrastrukturës dhe Bordit të Lartë të Burimeve. Buxhetet e NATO-s u nënshtrohen edhe kontrolleve të jashtëtëm.

8. Asambleja Parlamentare

Asambleja parlamentare e NATO-s, e njohur si Asambleja e Atlantikut Verior, është një organizatë ndërparlamentare e krijuar në vitin 1955 si forum që bashkon ligjvënësit e vendeve anëtarë për të diskutuar çështje me interes të përbashkët. Gjatë 15 vjetëve të kaluar, kjo Asamble e ka zgjeruar shumë anëtarësinë e saj dhe kuadrin e veprimit.

Asambleja është tërësisht e pavarur nga NATO por përfaqson megjithatë lidhjen ndërmjet Parlamenteve Kombëtarë dhe NATO-s dhe si e tillë ajo i nxit qeveritë që të marrin parasysh interesat e Aleancës për përpunimin e legjislacioneve të tyre. Diskutimet e mbajtur në asamble japin shpjegime të qartë për publikun e qëndrimet parlamentare kundrejt politikave të Aleancës. Në këtë këndvështrim, Asambleja ka një rol të tërthortë por ende të madh në procesin e formësimit të politikës së NATO-s.

9. Shoqata e Traktatit të Atlantikut (ATA)

Shoqata e Traktatit të Atlantikut (ATA) është një organizatë joqeveritare ndërkombëtare e krijuar në vitin 1954 nga shtetet anëtarë të NATO-s. synimi i saj kryesor ka qenë formimi i opinionit publik pozitiv në lidhje me misionin e NATO-s gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë. Pas rënies së Perdes së Hekurt, ATA u zhvillua si një organizatë e aftë për të lartësuar e propaganduar vlerat euroatlantike edhe përtej shteteve anëtarë të NATO-s. Kjo Shoqatë bëri ndryshime vendimtare në kushtetutën e saj duke i lejuar shtetet joanëtarë që ndjekin politikën e integritimit Atlantik të bëhen anëtarë të asociuar të saj. Në vitin 1992, Klubi Atlantik i Bullgarisë ishte e para organizatë që u pranua si anëtar i asociuar i ATA-s që përfaqsonte një vend joanëtar të NATO-s.

Objektivat e ATA-s janë:

- Të edukojë e informojë publikun për misionet e përgjegjësitë e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut.

- Të bëjë kërkime për synimet e veprimtaritë e larmishme të NATO-s dhe shtrirjen e tyre në vendet e Europës Qendrore Lindore si dhe të vazhdojë dialogun me shtetet mesdhetare.
- Të lartësojë solidaritetin e popujve të zones së Atlantikut të Veriut dhe të atyre që janë pjesë e Nismës së Partneritetit për Paqe.
- Të lartësojë demokracinë.
- Të zhvillojë bashkëpunimin ndërmjet të gjithë anëtarëve të saj.

10. Përmasat e Shndërrimit të NATO-s.

Mjedisi i sigurisë që po ndryshon me shpejtësi kërkon që shndërrimi i NATO-s të jetë i frytshëm. Aleanca ka nevojë që të gjejë barazpeshën e re ndërmjet misioneve të saj në Europë dhe trajtimit të kërcënimeve botërore. Ajo ka nevojë të ketë aftësi ushtarake më të shpejta, më të zhdërvjellta e më të frytëshme për t'u përballur më mire me shqetësimet e sigurisë. Duke mbajtur parasysh mjedisin e ri të sigurisë, është detyrë e dorës së pare të punohet ngushtësisht me një rreth më të gjerë partnerësh.

Kërcënimet që po përball NATO sot nuk janë aq katastrofike sa ishin gjatë Luftës së Ftohtë por ata janë shumë realë dhe shpesh të paparashikueshëm. Terrorizmi, përhapja e armëve të shkatërrimit masiv (WMD) si dhe konfliktet etnikë – të gjitha çështje bashkëkohore – kërkojnë përshtatjen e vazhdueshme të NATO-s ndaj natyrës së kërcënimeve botërore në mënyrë të tillë që ajo të ofrojë siguri e t'u kundërpërgjigjet nevojave të shteteve të saj anëtarë.

Procesi i shndërrimit të NATO-s ka përmasa të ndryshme të cilat mund të grupohen si më poshtë: **misionet e rinj, aftësitë e reja, anëtarët e partnerët rinj.**

Deri tani, kemi treguar sesi punon Aleanca për të zhvilluar **aftësitë** e saj ushtarake për t'u bërë edhe më e frytëshme brenda mjedisit të ri të sigurisë. Ne kemi folur për fazat e ndryshme të zgjerimit të NATO-s, sidomos në vitet e Pasluftës së Ftohtë. Në pjesët që do të vijojnë do të flasim për perspektivat e pranimit të **anëtarëve** të rinj. Në lidhje me **partnerët** e NATO-s, Aleanca po përqendrohet te partneritetet e saj me vende nga Kaukazi i Jugut dhe Azia Qendrore si dhe synon të forcojë bashkëpunimin e saj me vendet e Mesdheut e të Lindjes së Mesme të Zgjeruar.

Më poshtë, do të flasim për **misionet** e NATO-s si brenda ashtu edhe përtej hapësirës tradicionale transatlantike të përgjegjësisë.

11. Zgjerimi i NATO-s – Politika e *Dyerve të hapura*

Në Mbledhjen e Nivelit të Lartë të NATO-s në Stamboll në qershor 2004, NATO ripohoi politikën e saj të *dyerve të hapura*. Kryetarët e shteteve të vendeve

anëtarë e përshëndetën përparimin e arritur nga Shqipëria, Kroacia e Maqedonia në zbatimin e Planit të Veprimit për Anëtarësim të NATO-s si dhe i vlerësuan ata për ndihmën e dhënë për sigurinë e bashkëpunimin rajonal. Ata, gjithashtu, nxitën për përpjekje të mëtejshme të vendeve kandidatë për plotësimin e reformave të nevojshme dhe u përkushtuan për mbështetje të mëtejshme të kandidatëve në procesin e anëtarësimit. Bullgaria u përfshi gjallërisht në vendimin për rishikimin e përparimit të kandidatëve në rrugën e tyre drejt anëtarësimit të plotë në Mbledhjen pasardhëse të Nivelit të Lartë të NATO-s. Ky ishte tregues i rëndësishëm për mundësinë shumë të madhe që kishte Mbledhja tjetër e Nivelit të Lartë për t'u bërë ftesa atyre vendeve kandidatë që janë të afta të mbajnë përgjegjësitë e anëtarësimit në NATO.

12. Misionet e Operacionet e NATO-s

a. Hapësira e përgjegjësisë së NATO-s

Një prej anëve më të rëndësishme të shndërrimit të NATO-s ka qenë vendimi për të ndërmarrë operacione paqeruajtës dhe rregullime krizash si brenda ashtu edhe jashtë hapësirës euroatlantike. Tani, NATO mund të përcaktohet si **një organizatë rajonale me përgjegjësi botërore**. Aleanca është shndërruar në një organizatë të aftë që pranojë se kërcënimet nuk janë më të lidhur me një hapësirë të caktuar gjeografike dhe ajo zotëron edhe aftësitë për t'u përballur me to kurdoherë e kudo që të jenë.

Gjatë viteve 1990, për herë të parë, NATO u përfshi në mision paqeruajtës në Ballkan, ku konfliktet e përgjakshëm që vijuan pas shpërbërjes së ish Jugosllavisë, krijuan kërcënime seriozë jo vetëm për sigurinë rajonale por edhe për pjesën tjetër të Europës. Nëpërmjet misioneve të saj në Afganistan e ndihmës për trainim në Irak, Aleanca provoi se ajo ishte e aftë edhe për t'u përballur me sfida jashtë hapësirës së saj tradicionale të përgjegjësisë – hapësirës Euroatlantike.

b. NATO në Ballkan – Bosnja e Hercegovina, Kosova, Republika e Maqedonisë

Pas shpërbërjes së ish Jugosllavisë, NATO luajti rol vendimtar në proceset e reformave në Ballkan.

Ndërmjet viteve 1992 dhe 1995, NATO mbështeti gjallërisht përpjekjet e OKB-së për ndalimin e luftimeve në **Bosnje e Hercegovinë**. Sulmet ajrore kundër forcave serbe të Bosnjës në gusht e shtator të vitit 1995 e ndryshuan përpjestimin ndërmjet forcave tokësore dhe i çuan palët ndërluftuese më pranë bisedimeve zyrtare të cilat çuan në nënshkrimin e Marrëveshjes së Dayton-it në fund të vitit. Vetëm disa ditë më vonë, nën mandatin e OKB-së, Aleanca vendosi forca shumëkombëshe në Bosnje e Hercegovinë për zbatimin e Marrëveshjes së Paqes (Implementation Force

– IFOR). Këto forca kishin për detyrë ruajtjen e armëpushimit, ndarjen e forcave ushtarake të njësive administrative të sapokrijuara (Federata Boshnjake dhe Republika Serbe), kontrollin e transferimit të territoreve ndërmjet këtyre dy njësive si dhe ruajtjen e armëve të rënda në vende të caktuar. Objektivat kryesorë u arritën dhe, më pas, në dhjetor 1996, IFOR-i u zëvendësua me Forcën Stabilizuese – SFOR-in.

Përveç garantimit të një mjedisi të qendrueshëm për vazhdimin pa pengesa të procesit të paqes, SFOR-i u përkushtua edhe për mbështetjen e një vargu organizatash civile që punonin në drejtim të forcimit të paqes në Bosnje e Hercegovinë. SFOR-i ndihmoi edhe në kthimin e refugjatëve e të njerëzve të zhvendosur në shtëpitë e tyre, ndihmoi në reformën e forcave të armatosura të Bosnjes dhe në procesin e burgosjes së atyre njerëzve që ishin akuzuar për krime lufte dhe të dorëzimit të tyre në Gjykatën Ndërkombëtare për Krimet në ish Jugosllavi (ICTY).

Me kthimin e sigurisë në këtë vend, personeli i forcave të armatosura u pakësua dalëngadalë derisa SFOR-i e përfundoi misionin e tij në fund të vitit 2004. Në 2 dhjetor 2004, përgjegjësia kryesore për forcimin e paqes në këtë vend u mor nga misioni ushtarak i Bashkimit Europian (EU) i quajtur *Althea*. Duke synuar sigurimin e një kalimi të butë ndërmjet forcave paqeruajtëse dhe një bashkërendim më të mire me BE-në, NATO e ruajti praninë e saj në Bosnjë e Hercegovinë me Shefin e Shabit të saj në Sarajevë.

NATO e përdori ndërhyrjen ushtarake si mjetin e fundit në Kosovë pas një viti dhunë që përshkallëzohej dhe shpërfilljeje këmbëngulëse nga rregjimi i Beogradit të rezolutës së Këshillit të Sigurisë së OKB-së e cila kërkonte ndalimin e shtypjes së popullsisë shqiptare të kësaj zone. Pasi i shteroi të gjitha mjetet diplomatike dhe pas dështimit të vazhdueshëm të bisedimeve për paqe, në mars të vitit 1999, Aleanca vendosi të nisë sulmin ajror kundër strukturave ushtarake e paraushtarake të qeverisë jugosllave. Fushata e sulmeve ajrore vazhdoi 78 ditë.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes ushtarake ndërmjet NATO-s e komandës jugosllave, nën një mandate të OKB-së, NATO vendosi atje Forcën e Kosovës – KFOR-in. Kjo forcë kishte për detyrë të parandalonte rrezikun e mundshëm të rifillimit të konfliktit luftarak, të çarmatoste Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe të mbështeste operacionet humanitare të misionit të OKB-së në Kosovë – UNMIK-un dhe organizata të tjera joqeveritare ndërkombëtare.

Operacioni i NATO-s në Kosovë vazhdon edhe tani. Aleanca, në bashkëpunim të ngushtë me UNMIK-un, ndihmon për krijimin e një mjedisi më të sigurtë, brenda të cilit të gjithë qytetarët, pavarësisht prej prejardhjes së tyre etnike, të mund të jetojnë në paqe. Kjo është një detyrë e vështirë e cila kërkon kohë, por e rëndësishme është të mbahet mend se mjedisi civil po rikrijohet me sukses dhe se popullsia vendase po rikthehet dalëngadalë në një mënyrë jetese normale.

NATO ndërhyri në Republikën e Maqedonisë në gusht të vitit 2001, pas kërkesës së Presidentit maqedonas për çarmatosjen e një grupi shqiptarësh etnikë që mundoheshin të detyronin qeverinë të garantonte më shumë të drejta për pakicën etnike shqiptare. Veprimet e këtij grupi shqiptar kishin vënë në rrezik sigurinë e qendrueshmërinë e vendit. Nëpërmjet një operacioni 30-ditor, 3500 ushtarë të NATO-s arritën të konfiskojnë 4000 armë. Ky operacion ndihmoi për të shmangur përshkallëzimin e një konflikti civil të armatosur dhe përgatiti kushtet e nevojshme për pajtimin e riorganizimin e vendit. Pas kësaj, Aleancës iu kërkuar të mbante një force të vogël të armatosur në Republikën e Maqedonisë për të garantuar mbrojtjen e vëzhguesve të BE-së e OSBE-së të cilët mbikëqyrnin zbatimin e Kornizës së Projektit të Paqes. Ky Projekt u miratua nga përfaqësues të bashkësisë etnike shqiptare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Në mars të vitit 2003, misioni i NATO-s u zëvendësua nga BE.

c. NATO në Afganistan

Në gusht të vitit 2003, NATO mori si detyrë forcat e sigurisë ndërkombëtare në **Afganistan (ISAF)**, roli i të cilave ishte të ndihmonin qeverinë e përkohëshme të vendit për krijimin e një mjedisi më të sigurtë për qytetarët e Kabulit e të rrethinave të tij. Në atë kohë, ky vend po përpiqej të rindërtohej pas dy dhjetëvjeçarësh të një lufte civile, të pasuar nga rregjimi shkatërrimtar i Talibanëve i cili u dha strehë politike edhe terroristëve.

ISAF-i është force ndërkombëtare nën emblemën e OKB-së, e cila u krijua në dhjetor të vitit 2001. Operacioni i parë u kryesua nga Britania e Madhe dhe në të morën pjesë edhe forca të vendeve të tjerë, pjesa më e madhe e të cilave ishin nga vende anëtarë të NATO-s. Udhëheqja e ISAF-2 u muar nga Turqia kurse ajo e ISAF-3 nga Gjermania e Holanda së bashku. Mandati fillestar i këtyre forcave ishte i kufizuar me operacione në Kabul e në rrethinat e tij, por pas tetorit të vitit 2003, pas një resolute të Këshillit të Sigurisë të OKB-së, ai u shtri edhe me operacione jashtë Kabulit.

NATO pranoi gjithashtu që të zgjerojë misionin e saj jashtë Kabulit nëpërmjet krijimit të ekipeve vendore civile-ushtarake (PRT-s) në krahina të ndryshme të dhe nëpërmjet vendosjes së përkohëshme të forcave ISAF për detyra të veçanta. Qysh nga fundi i vitit 2003, Aleanca mori komandën e një PRT-je të udhëhequr nga gjermanët në krahinën e Cunduz-it. Deri në vitin 2004, kur përfundoi faza e parë e zgjerimit të ISAF-it, NATO i kishte krijuar tashmë aftësitë për të ndikuar në mjedisin e sigurisë në 9 krahina të Afganistanit të veriut.

Faza e dytë e shtrirjes së ISAF-it filloi në shkurt të vitit 2005. Pas përfundimit të saj, ISAF-i do të marrë praktikisht përgjegjësinë për sigurinë e 50% të territorit të Afganistanit.

d. Roli i NATO-s në Irak

Gjatë mbledhjes së Këshillit të Atlantikut Verior, në 28 qershor të vitit 2004 në Mbledhjen e Nivelit të Lartë të Stambollit, Kryetarët e Shteteve miratuan Deklaratën për Irakun në të cilën shtetet anëtarë shprehën miratimin e tyre e mbështetjen e plotë për forcat shumëkombëshe në Irak.

Mbështetur në Rezolutën Nr. 1546 të Këshillit të Sigurisë të OKB-së, NATO filloi misionin e saj në Irak (NTM-I). Në thelbin e tij, ky mision nuk ka natyrë suhtarake. Objektivi i tij themelor është dhënia e ndihmës stërvitore për forcat ushtarake e shërbimet e sigurisë të shtetit të Irakut.

NTM-I është një operacion i veçantë por plotëson përpjekjet e përgjithëshme ndërkombëtare për rindërtimin e Irakut. Tani, struktura kryesore vepruese e këtij misioni është vendosur në të ashtuquajturën *Zonë e Gjelbër* e Bagdadit dhe numri i përgjithshëm i trupave pritet që të rritet deri në 1265.

13. Roli i NATO-s për sigurinë civile

Aleatët e NATO-s kanë bashkëpunuar për një kohë të gjatë në fushën e planifikimit civil për gjendjet emergjente. Vitet e fundit, ky bashkëpunim përfshiu edhe partneret e NATO-s. Në fushën e mirëkujdesjes për burimet në gjendjet e emergjencës, NATO ka arritur përparim të madh.

Me qëllim që të plotësojë më mirë nevojën për një bashkërendim më të mirë të aftësive euroatlantike në kundërpërgjigje në raste të fatkeqësive, në vitin 1998, NATO krijoi në Zyrat e saj Qendrore një Qendër të Bashkërendimit Euroatlantik për Kundërpërgjigje ndaj Fatkeqsive (EADRCC). Kjo Qendër lehtëson grumbullimin e informacionit dhe organizon stërvitje praktike për kundërveprimin ndaj gjendjeve emergjente, e cila u jep zgjidhje praktike rasteve të fatkeqsive natyrore e të shkaktuara nga njeriu.

Shembuj: EADRCC mori pjesë në operacionet e ndihmës humanitare gjatë krizës së refugjatëve në Kosovë. Kjo Qendër arriti gjithashtu suksese të qendrueshme gjatë vërshimeve shkatërruese në Ukrainë, Rumani, Hungari, Shqipëri e Republikën Çeke, gjatë tërmetit në Turqi në vitin 1999, gjatë zjarreve në pyje në Republikën e Maqedonisë dhe Portugali, në kushtet e ashpra klimaterike në Ukrainë e Moldovë dhe pas tërmetit në Pakistan.

14. Bashkëpunimi me Organizata të tjera Ndërkombëtare

Pavarësisht prej faktit se në rolet e tyre Aleanca e Atlantikut të Veriut, OSBE-ja dhe organizata të tjera ndërqeveritare ndryshonë shumë, praktikisht, bashkëpunimi

i tyre dhe mbështetja e ndërsjellë janë të domosdoshme meqenëse asnjë organizatë nuk punon e izoluar.

• **Kombet e Bashkuar (OKB)**

Pas vitit 1949 dhe deri në përfundimin e Luftës së Ftohtë, ndërveprimi i OKB-së e NATO-s ishte shumë i kufizuar, si në gjerësi edhe në përmbajtje. Ngjarjet në Europë që nisën në fillim të viteve 1990, të tilla si konflikti në ish Jugosllavi dhe shpërbërja e Traktatit të Varshavës, e ndryshuan shumë gjendjen.

Në dhjetor të vitit 2002, Ministrat e Jashtëm të NATO-s deklaruan zyrtarisht gatishmërinë e Aleancës për të udhëhequr operacione paqeruajtës nën emblemën e Këshillit të Sigurisë të OKB-së. NATO bëri një rishikim të masave të ndërmarra si në emër të anëtarëve të veçantë ashtu edhe në emër të Aleancës. Kjo organizatë deklaroi se ishte e përgatitur për t'iu kundërpërgjigjur çdo nisme tjetër të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së e cila kërkonte bashkëpunimin e NATO-s në këtë fushë.

Në vitin 1992, në rrethanat e përshkallëzimit të konfliktit në ish Jugosllavi, anijet e NATO-s të Forcave të Përherëshme Detare të Mesdheut ndihmuan nëpërmjet kontrollit nga deti të forcave ajrore, ndërmorën operacione mbikqyrëse në Detin Adriatik për të mbështetur zbatimin e rregjimit të embargos të OKB-së kundër furnizimit me armë për të gjithë shtetet e saj Jugosllavisë. Në nëntor të vitit 1992, NATO dhe Bashkimi Europian Perëndimor (WEU) ndërmorën operacione për zbatimin e sanksioneve të Rezolutës së Këshillit të Sigurisë të OKB-së të cilat synonin parandalimin e përshkallëzimit të konfliktit në një kohë kur në rajon ishin dërgua armë kundër kësaj embargoje.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Paqes të Dayton-it, në vitin 1995, NATO dhe OKB e vazhduan bashkëpunimin e tyre në Bosnjë e Hercegovinë brenda mandatit të dy forcave shumëkombëshe në këtë vend – IFOR-it dhe misionit që e pasoi atë – SFOR-it.

Një shembull tjetër i bashkëpunimit është kriza e Kosovës ku qysh prej fillimit të konfliktit në vitin 1998 dhe gjatë përshkallëzimit e zbutjes së tij, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së dhe Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s punuan ngushtë së bashku, megjithëse Rezoluta e OKB-së për sulmet ajrore mbi Kosovë nuk ishte siguruar.

Jashtë rrethanave të ish Jugosllavisë, shtetet anëtarë të NATO-s vazhduan të mbështetin përpjekjet e Këshillit të Sigurisë të OKB-së dhe të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për parandalimin e konflikteve e rivendosjen e ligjit. Në fillim të vitit 1998, ndërkohë që zbatonte në Irak Rezolutat e Këshillit të Sigurisë të OKB-së dhe udhëhiqte një rregjim inspektimi që synonte zbulimin e shkatërrimin e armëve të

shkatërrimit në masë dhe pajisjet për prodhimin e tyre, NATO i bëri thirrje Irakut që t'u nënshtronte kushteve që ishin shënuar në këto rezoluta.

Tani, NATO e OKB punojnë së bashku në Afganistan.

Në 11 nëntor 2004, për herë të parë në historinë e NATO-s, Sekretari i Përgjithshëm i saj mori pjesë në mbledhjen e Këshillit të Sigurisë të OKB-së. Kjo mbledhje i kushtohej Bosnjë e Hercegovinës. Ndërkohë që mbante fjalimin e tij, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Z. Jaap de Hoop Scheffer, e vuri theksin te rëndësia e NATO-s si një mjet i provuar i dialogut e veprimit si dhe nënvizoi se NATO nuk ishte duke ndjekur rolin e ndonjë polici botëror. Sipas deklaratës së tij, procesi i zgjerimit të misionëve të Aleancës është një parakusht për thellimin e partneritetit të saj me OKB-në.

• **Bashkimi European (BE)**

Ndërmjet viteve 1950 e viteve 1980, praktikisht nuk ekzistonin marrëdhënie institucionale ndërmjet NATO-s e Komunitetit European (KE).

Nëpërmjet Traktatit të Bashkimit European, të nënshkruar në vitin 1991 e të zbatuar në vitin 1993, anëtarët e BE-së u morën vesh për krijimin e një Politike të Përbashkët të Jashtme e të Sigurisë (CFSP). Ky Traktat përfshinte edhe konturimin e një politike të përbashkët për mbrojtjen.

Përvoja e fituar gjatë krizës ballkanike në vitet 1990 u dha vull shteteve të BE-së që të marrin masa konkrete në fushën e sigurisë. BE i përshpejtoi përpjekjet e saj për t'i dhënë formë Politikës Europiane të Mbrojtjes e të Sigurisë si dhe për të zhvilluar aftësitë përkatëse operacionale. Në fillim, në emër të BE-së, çështjet e sigurisë e të mbrojtjes u diskutuan në një grup të veçantë brenda Bashkimit European Perëndimor (WEU). Në Mbledhjen e Nivelit të Lartë të Helsinkit të vitit 1999, shtetet e BE-së morën vendimin që të zhvillojnë aftësitë e veta në lidhje me sigurinë e mbrojtjen si dhe të krijojnë strukturat e domosdoshme për këtë qëllim.

Në Mbledhjen e Nivelit të lartë të NATO-s në Washington në prill të vitit 1999, udhëheqësit e NATO-s miratuan synimin e BE-së për të zhvilluar struktura të sigurisë. Udhëheqja e NATO-s shprehu edhe gatishmërinë e saj për të ofruar e zbatuar masa që e kalonin një pjesë të madhe të aftësive ushtarake të NATO-s te operacionet e udhëhequr nga BE, në të cilët NATO nuk do të përfshihej. Pas Helsinkit, NATO nisi këshillime e diskutime të drejtpërdrejtë me BE-në në lidhje me të ardhmen e bashkëpunimit ndërmjet të dy këtyre institucioneve.

Më vonë, NATO e BE përcaktuan forma të reja të veçanta bashkëpunimi. Në dhjetor të vitit 2002, NATO e BE nënshkruan një Deklaratë të Përbashkët për partneritet

strategjik. Në mars, ata miratuan një numër dokumentesh në lidhje me bashkëpunimin për mirëkujdesje për krizat, përfshirë Marrëveshjet Berlin Plus, sipa të cilave burimet e aftësitë e NATO-s mund të përdoren nga BE në misionet e udhëhequr nga kjo e fundit.

Operacioni *Concordia* në republikën e Maqedonisë në vitin 2003 ka qenë operacioni i parë paqeruajtës i udhëhequr nga BE, i realizuar në kuadrin e Marrëveshjeve Berlin Plus. Operacioni i BE-së, *Althea* është duke u zbatuar tani në kuadrin e të njejtave marrëveshje, pasi *Althea* ndërmoi udhëheqjen e SFOR-it në Bosnjë e Hercegovinë.

NATO e BE punojnë ngushtësisht së bashku sidomos në proceset paralele të zhvillimit të aftësive ushtarake në të dyja organizatat.

Aleanca dhe BE-ja e kanë shfaqur vullnetin e tyre për bashkërendimin e përpjekjeve kundër kërcënimit të terrorizmit ndërkombëtar dhe përhapjes së armëve të shkatërrimit masiv (WMD).

Qysh prej vitit 2003, të dyja këto organizata janë duke zbatuar një mënyrë të bashkërenduar trajtimi për zhvillimin e Ballkanit Perëndimor çka provon se ata kanë synime e vendosmëri të njejtë për stabilizimin e këtij rajoni.

Me qëllim që të bashkërendojnë përpjekjet e tyre për bashkëpunimin strategjik në fusha të larmishme interesi, NATO e BE organizojnë mbledhje të rregullta zyrtare e pune në nivele të ndryshëm.

• OSBE

Në cilësinë e saj si forumi i vetëm që i bashkon të gjithë vendet e Europës bashkë me Kanadanë e Sh.B.A.-në, **Organizata për Siguri e Bashkëpunim në Europë** (OSCE) është përbërës vendimtar i arkitekturës së sigurisë të kontinentit europian. OSCE siguron kornizë të gjerë bashkëpunimi në fushën e të drejtave të njeriut, lirive themelore, demokracisë, sundimit të ligjit, sigurisë dhe zhvillimit ekonomik.

Qysh prej themelimit të Konferencës për Siguri e Bashkëpunim në Europë e cila më pas u shndërrua në Organizatë për Sigurinë e Bashkëpunimin në Europë, NATO ka propaganduar gjallërisht në të mirë të veprimeve të saj. Me deklaratën e Madridit për Siguri e Bashkëpunim Euroatlantik duke nisur prej vitit 1997, Kryetarët e Shteteve të NATO-s e njohën OSCE-në si organizatën më gjithëpërfshirëse të sigurisë në Europë. Ata nënvizuan edhe rolin e saj vendimtar për garantimin e paqes, qëndrueshmërisë dhe sigurisë në continent si dhe theksuan pranueshmërinë e parimeve dhe përkushtimeve të saj si themel i forte për zhvillimin e strukturave të përbashkëta për sigurinë europiane.

OSCE dhe NATO kanë punuar ngushtësisht si pjesë e përpjekjeve ndërkombëtare për vendosjen e paqes në ish Jugosllavi. Në mënyrë të veçantë, marrëdhënie të ngushta kanë ekzistuar ndërmjet OSCE-së dhe IFOR-it, i cila më pas u shndërrua në SFOR, në Bosnjë e Hercegovinë, si dhe ndërmjet OSCE-së e KFOR-it, në Kosovë. Për shembull, IFOR-i mbështeste OSCE-në në përgatitjen e zgjedhjeve të shtatorit të vitit 1996. SFOR-i dha të njëjtën ndihmë për OSCE-në në procesin e organizimit e realizimit të zgjedhjeve vendore të vitit 1997.

Kriza e Kosovës bëri që bashkëpunimi ndërmjet OSCE-së dhe NATO-s të ngrihet në një nivel të ri. Deri në ditët tona, KFOR-i vazhdon të mbështetë OSCE-në si dhe organizata të tjera ndërkombëtare të përfshira në Kosovë nëpërmjet sigurimit të mjedisit të domosdoshëm të sigurisë për realizimin e detyrave të tyre në terren.

Një prej përparësive të kryesisë bullgare të OSCE-së në vitin 2004 ka qenë pikërisht puna për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet NATO-s e OSCE-së.

15. NATO dhe Lufta kundër Terrorizmit

Një ditë pas ngjarjeve tragjike të New York-ut dhe Washington-it të 11 shtatorit të vitit 2001, Këshilli i Atlantikut Verior e deklaroi këtë **veprim terrorist si një sulm kundër të gjithë shteteve anëtarë**. Kjo ka qenë **hera e parë që NATO i drejtohej Nenit 5 të Traktatit të Washington-it** i cili merret me mbrojtjen e përbashkët.

Një vit më vonë, në Mbledhjen e nivelit të Lartë të Pragës, aleatët miratuan një numër nismash për forcimin e aftësive të NATO-s për të luftuar terrorizmin dhe për të përballur kërcënimet e rinj të sigurisë. U paraqit edhe një Koncept Ushtarak për Mbrojtjen kundër terrorizmit. Shtete anëtarë miratuan një Plan Veprimi kundër terrorizmit i cili përfshinte të gjithë shtetet partnerë së bashku me shkëmbimin e informacioneve inteligjente si dhe përmirësimin e gatishmërisë për një sulm të mundshëm kundër popullsisë civile me armë bërthamore, kimike dhe biologjike.

Në këtë këndvështrim, NATO miratoi pesë nisma mbrojtëse kundër armëve bërthamore, kimike e biologjike. Një prej përfundimeve të drejtpërdrejta ka qenë krijimi në dhjetor të vitit 2003 i Batalionit Shumëkombësh kundër CBRN (armëve kimike, biologjike, radiologjike e bërthamore), Shefi i Shtabit të të cilit e ka selinë në Liberetz të Republikës Çeke. Ky batalion, që përbëhet nga përfaqësuesit e 13 shteteve anëtarë është pjesë përbërëse e Forcave të Kundërpërgjigjes të NATO-s.

Përveç kësaj, NATO nisi një kërkim të pavarur në fushën e mbrojtjes me raketa balistike si dhe filloi hulumtimin e rrugëve për forcimin e aftësive të saj për mbrojtje kundër sulmeve kibernetike.

Në nëntor të vitit 2003, në Zyrat Qendrore të NATO-s u krijua një Njësi e Intelligjencës për Kërcënimet Terroristë qëllimi i së cilës ishte mbështetja e mundësive për shkëmbim të informacioneve inteligjente ndërmjet shteteve anëtarë. Veç kësaj, u krijua një mekanizëm për lehtësimin e shkëmbimit të informacioneve inteligjentë mbi kërcënimet terroristë me vendet partnere të Këshillit të Partneritetit Euroatlantik dhe ata të Dialogut Mesdhetar.

Në Mbledhjen e Nivelit të Lartë të Stambollit të qershorit të vitit 2004, Kryetarët e Shteteve miratuan listen e masave për luftën kundër terrorizmit.

16. NATO e Rusia

NATO është duke e zhvilluar bashkëpunimin e saj me rusinë qysh prej fillimit të viteve 1990. arësyeja e këtij partneriteti është e qartë: ai lejon që t'i bëhet një qëndresë më e mire kërcënimeve të përbashkët të sigurisë. Sigurisht, pjesmarrja e Rusisë ka rëndësi vendimtare për çdo sistem sigurie gjithëpërfshirës në Europë pas përfundimit të Luftës së Ftohtë.

Megjithëse marrëdhëniet me Rusinë e kanë prejardhjen në fillim të viteve 1990 (në vitin 1991, ky vend ka qenë një prej themeluesve të Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut Verior dhe qysh prej vitit 1994 ai ka marrë pjesë në Partneritetin për Paqe), themelet e këtij bashkëpunimi u hodhën nëpërmjet nënshkrimit të **Aktit të Themelimit NATO-Rusi** në paris, më 27 maj, 1997. kjo ngjarje shënoi themelimin e **Këshillit të Përbashkët të Përhershëm NATO-Rusi (PJC)** si forum për këshillime të rregullt për çështjet e sigurisë.

Megjithatë, objektivat e pasqyruar në Aktin e Themelimit nuk u zbatuan tërësisht në këshillin e Përbashkët. Njëkohësisht, qëndrimet e ndryshëm të NATO-s e Rusisë në lidhje me krizën e Kosovës dhe sidomos me fushatën ajrore të udhëhequr nga Aleanca në vitin 1999, çuan në ndërprerjen njëvjeçare të Sesioneve të Këshillit të Përbashkët të Përhershëm.

Ngjarjet tragjike të 11 shtatorit 2001 u dhënë vull marrëdhënieve ndërmjet dy palëve. Në qershor të vitit të mëpasëm, Rusia e NATO nënshkruan **Deklaratën e Romës**, nëpërmjet së cilës këshilli ekzistues u zëvendësua nga një forum i ri për bashkëpunim – **Këshilli NATO-Rusi (NRC)**. Në vetë thelbin e tij, ky Këshill është mishërim i idesë së këshillimeve, krijimit të konsensusit, marrjes së vendimeve e kryerjes së veprimeve të përbashkët, pra, i krijimit të rrethanave në të cilat shtetet anëtarë të NATO-s e Rusia do të bashkëpunojnë mbi themele të barabartë.

Këshilli NATO-Rusi merret me të gjitha fushat me interes të përbashkët. Për të realizuar këto detyra, ky këshill ndihmohet nga një numër grupesh pune dhe

komitetesh që merren me: luftën kundër terrorizmit, mospërhapjen e armëve të shkatërrimit masiv, mirëkujdesjen për krizat, kontrollin e armëve dhe krijimin e besimit, bashkëpunimin ushtarak, reformën në mbrojtje, planifikimin civil në gjendje emergjente, bashkëpunimin shkencor, etj.

Bashkëpunimi NATO-Rusi po zgjerohet me kalimin e viteve. Për shembull, në dhjetor të vitit 2004, të dyja palët nënshkruan një **Memorandum për Bashkëpunim** dhe miratuan një Plan Veprimi kundër terrorizmit, sipas të cilit Rusia pranoi që të ndihmonte operacionin e NATO-s *Active Endeavour* në Mesdhe. Në prill të vitit 2005, u miratua **Marrëveshja për Statusin e Forcave** (SOFA) në përputhje me Partneritetin për Paqe. Ajo krijoi stukturën ligjore të nevojshme dhe, praktikisht, krijoi aftësitë për veprime të përbashkët NATO-Rusi për përballjen me sfidat e përbashkëta të sigurisë.

17. NATO e Ukraina

Marrëdhëniet ndërmjet NATO-s e Ukrainës përparuan shpejt pas shpalljes së pavarësisë së vendit, në vitin 1991. Në të njejtin vit, Ukraina u bë anëtare e Këshillit të bashkëpunimit të Atlantikut Verior dhe në vitin 1994, u bë vendi i parë i Komunelthit të Shteteve të Pavarur (CIS) që u bë anëtar i Partneritetit për Paqe. Në maj të vitit 1997, Ukraina ishte njëra prej themelueseve të Këshillit të Partneritetit Euroatlantik. Gjatë të njejtin vit, ky vend nënshkroi **Kartën e Partneritetit të Veçantë** e cila krijoi zyrtarisht themelet për bashkëpunimin ndërmjet Ukrainës dhe NATO-s si dhe u krijua **Komisionin NATO-Ukrainë** (NUC) si grup përfaqësues i bashkëpunimit të vendosur.

Përparim i rëndësishëm në bashkëpunimin u bë në dhjetor të vitit 2002, me miratimin e **Planit të Veprimit** ndërmjet NATO-s e Ukrainës. Ky plan përpunoi modelin e partneritetit e këshillimeve veprues në shumë fusha: çështjet politike e konomike, çështjet informative, çështjet ushtarake dhe çështjet e sigurisë e të mbrojtjes. Plani i Ri i Veprimit njehsonte qartë objektivat e përparësitë strategjike të Ukrainës në rrugën e saj drejt integritit të plotë në strukturat Euroatlantike. Ky Plan përcaktonte edhe hapësirën strategjike të bashkëpunimit të tanishëm e të ardhshëm ndërmjet NATO-s e Ukrainës.

Në prill të vitit 2005, nisi një faze e re në marrëdhëniet ndërmjet NATO-s e Ukrainës. Gjatë mbledhjes jozyrtare të Komisionit NATO-Ukrainë, Ministrat e Jashtëm morën vendim për krijimin e **Dialogut Intensiv** për aspiratat e Ukrainës për anëtarësim në NATO. Gjithashtu, ky Komitet miratoi një document mbi masat për thellimin e bashkëpunimit si dhe nënshkroi një marrëveshje që deklaronte ndihmën e Ukrainës për operacionin e NATO-s *Active Endeavour*.

18. Marrëdhëniet NATO-Shqipëri

Vështrim Kronologjik

Nëntor 1991 – një delegacion i nivelit të lartë të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë mori pjesë në një mbledhje të OSCE-së në Pragë, ku u vendosën kontakte me zyrtarë të lartë të NATO-s.

20 Dhjetor, 1991 – inaugurohet krijimi i Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut, fillimisht me pjesëmarrjen e vendeve të NATO-s dhe të nëntë vendeve të tjerë perëndimorë, me synimin për të zgjeruar marrëdhëniet e tij me vendet e bllokut lindor.

Qershor 1992 – në mbledhjen e Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut, Shqipëria pranohet si anëtare e kësaj organizate së bashku me vende të tjera.

Fund i vitit 1992 – një delegacion zyrtar i NATO-s, i kryesuar nga Z. John Kriendler, drejtor i departamentit politik, erdhi për vizitë në Shqipëri e u takua me autoritetet shqiptare.

Dhjetor 1992 - Presidenti i Shqipërisë, Z. Sali Berisha, vizitoi Selinë Qendrore të NATO-s në Bruksel dhe takoi Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Z. Manfred Werner. Presidenti mori pjesë në një session të posaçm të Këshillit të Atlantikut të Veriut dhe shprehu vullnetin e Shqipërisë për t'u anëtarësuar në NATO.

19 Mars, 1993 – Secretari i Përgjithshëm i NATO-s, Z. Manfred Werner, vizitoi Shqipërinë.

Janar 1994 - NATO bën të njohur Dokumentin Kornizë të Partneritetit për Paqe, si program praktik për shndërrimin e marrëdhënieve ndërmjet vendeve anëtarë të NATO-s e vendeve të tjerë ish komunistë të Europës Qendrore e Lindore.

22 Shkurt, 1994 – Presidenti shqiptar, Z. Sali Berisha, nënshkroi Dokumentin Kornizë të Partneritetit për Paqe, në Bruksel. Shqipëria bëhet anëtare e partneritetit për Paqe. Brenda një periudhe të shkurtër kohe, Shqipëria nënshkroi një numër dokumentesh zyrtarëqë krijojnë themelet ligjore të bashkëpunimit në kornizën e Partneritetit për Paqe.

20 Prill, 1994 – Parlamenti shqiptar ratifikoi Dokumentin Kornizë të Partneritetit për Paqe.

4 Qershor, 1994 - një grup intelektualësh të profesioneve të ndryshëm dhe bindjeve të ndryshme politike themeluan Shoqatën Shqiptare të Atlantikut (tani, Këshilli Atlantik i Shqipërisë qysh prej Mbledhjes së saj të Përgjithëshme të qershorit 2006).

25 Janar, 1995 – Shqipëria nënshkroi Programin Individual të parë të Partneritetit me NATO-n. qysh prej asaj kohe, çdo vit Shqipëria i ka paraqitur Programme Individuale Partneritetit NATO-s.

9 Qershor, 1995 – Shqipëria u përfshi në Procesin e Planifikimit dhe Rishikimit (PARP). Forcat e Armatosura të Shqipërisë filluan të marrin përvojë për procesin e planifikimit të mbrojtjes në përputhje me standardet e NATO-s.

1995 – Përgatitja e Forcave të Armatosura të Shqipërisë për të ndihmuar në Operacionin e Mbështetjes së Paqes dhe ata të ndihmës humanitare që filuan me pjesëmarrjen në stërvitjen ushtarake të NATO-s e Partneritetit për Paqe “Cooperative Nugget 95”, e cila u zhvillua në Louisiana, Sh.B.A.

1995 – Shqipëria vendosi t’i ofrojë NATO-s lehtësitë e saj aeroportuale në lidhje me konfliktin e armatosur në territoret e ish Jugosllavisë.

1996 – Shqipëria u përfshi në procesin e studimit të NATO-s për zgjerimin.

1996 – Në Shqipëri, pranë Tiranës, u zhvillua stërvitja ushtarake “Peaceful Eagle 96”, ku morën pjesë dymbëdhjetë vende anëtarë e partnerë të NATO-s me rreth 1300 trupa.

3 Maj, 1996 – Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Z. Javier Solana vizitoi Shqipërinë. Ai e ftoi Shqipërinë për një dialog individual me të gjitha strukturat e NATO-s çka do t’a institucionalizonte e programonte bashkëpunimin në të gjitha fushat.

7 Korrik, 1996 – u zhvillua sesioni i parë individual i dialogut zyrtar NATO-Shqipëri.

5 Shtator, 1996 – Parlamenti shqiptar miratoi një ligj mbi dërgimin e forcave ushtarake shqiptare në Bosnje-Hercegovinë për të marrë pjesë në operacionin SFOR së bashku me vende të tjera anëtare ose partnere të NATO-s.

30 Maj, 1997 - Në Sintra, Portugali, Shqipëria mori pjesë në mbledhjen e parë ministeriale të Këshillit të Partneritetit Euroatlantik (EAPC), i cili zëvendësoi Këshillin e Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut.

30 Tetor, 1997 – u hap zyra e Misionit Shqiptar në Selinë Qendrore të NATO-s, në Bruksel.

1998 – vendosja e një marrëdhënieje të posaçme ndërmjet NATO-s e Shqipërisë me krijimin e qendrës së NATO-s e të partneritetit për Paqe e cila u përdor edhe për dhënie këshillash e ndihme për autoritetet shqiptare si dhe për bashkërendimin e ndihmës së huaj.

Qershor 1998 – për shkak të gjendjes në Kosovë, Ministrat e jashtëm të NATO-s vendosën të marrin një numër masash siç janë stërvitjet ajrore në hapësirën ajrore të Shqipërisë.

1999 – Shqipëria ripërtëriu mbështetjen e saj për NATO-n duke ofruar lehtësi ajrore e detare në territorin e saj në mbështetje të operacionit të NATO-s në Kosovë.

23-24 Prill, 1999 – në Mbledhjen e Nivelit të Lartë të NATO-s në Washington, Shqipëria, së bashku me tetë vende të tjerë, u pranua si një vend kërkues për t'u anëtarësuar në NATO. Kjo Mbledhje krijoi mundësi të reja për pranimin e nëntë vendeve në NATO nëpërmjet miratimit të Planit të Veprimit për Anëtarësim (MAP) ku mori pjesë edhe Shqipëria.

Nëntor 1999 – Shqipëria paraqiti dokumentin e Planit të Veprimit për Anëtarësim (MAP). Shqipëria ka kaluar nëpër shtatë cikle të këtij procesi dhe tani po përgatitet për ciklin e tetë.

17 Qershor, 2002 – Shqipëria e NATO nënshkruan një marrëveshje për krijimin e një komande mbështetëse të quajtur “NATO Headquarters Tirana” si mbështetje konkrete trupat e KFOR-it në Kosovë dhe sigurinë e komunikimit rrugor Maqedonia-Durrës-Kosovë.

25 Korrik, 2002 – Parlamenti shqiptar miratoi një ligj për dërgimin e trupave ushtarake në Afganistan si pjesë e operacionit ISAF.

21 Nëntor, 2002 – në Mbledhjen e Nivelit të Lartë të NATO-s në Pragë, Sekretari i Përgjithshëm i NATO, Lord Robertson, deklaroi se dyert e NATO-s do të jenë të hapura për Shqipërinë si një vend kërkues për t'u anëtarësuar.

12 Shkurt, 2003 - tre Presidentët e Shqipërisë, Kroacisë dhe Maqedonisë, Z. Alfred Moisiu, Z. Stjepan Mesic, Z. Boris Trajkovski, u takuan në Tiranë për të diskutuar bashkëpunimin e mëtejshëm si vende kërkuese për t'u anëtarësuar në NATO.

9 Mars, 2003 – Qeveria shqiptare vendosi të marrë pjesë në operacionin “Iraqi Freedom” në Irak.

2 Maj, 2003 – Ministrat e jashtëm të Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kroacisë si vende partnerë, nënshkruan “*Adriatic Charter*”, në prani të Sekretarit të Shtetit të Sh.B.A.-së, Z. Colin Powell.

Korrik 2003 – Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Lord Robertson, bëri një vizitë zyrtare në Shqipëri dhe u takua me një grup të rinjsh të Shoqatës Shqiptare të Atlantikut (tani, Këshilli Atlantik i Shqipërisë).

27 Maj, 2004 – Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Z. Jaap de Hoop Scheffer, bëri një vizitë zyrtare në Shqipëri dhe mbajti një fjalim në mjedise të Shoqatës Shqiptare të Atlantikut (tani, Këshilli Atlantik i Shqipërisë).

Tetor 2004 – Në Mbledhjen e Nivelit të Lartë të NATO-s në Stamboll, udhëheqësit e vendeve të ndryshëm të NATO-s përshëndetën Shqipërinë për përpunimin e bërë në reforma, rolin e saj konstruktiv në qendrushmërinë rajonale dhe mbështetjen për Aleancën. Ata premtuan gjithashtu që të vazhdojnë ndihmën e tyre për përpunimin e reformave dhe nënvizuan politikën e dyerve të hapura të NATO-s kundrejt Shqipërisë.

6 Korrik, 2006 – Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Z. Jaap de Hoop Scheffer viziton Shqipërinë e mban një fjalim në Parlamentin shqiptar ku ripohon anëtarësimin e ardhshëm të Shqipërisë në NATO, pas Mbledhjes së Nivelit të lartë të NATO-s në Rigë, në varësi të përpekjeve të saj përkatëse.

19. Përse është e nevojshme NATO ? Zotimet e Përgjegjësitë kryesore.

Gjatë procesit të anëtarësimit, çdo vend ndërmori një numër përgjegjësisë e zotimesh:

1. Të venë në zbatim të gjithë dokumentet e tanishëm politikë e vendimet e NATO-s që janë në veprim në çastin e anëtarësimit, të cilët përfshijnë politika të bashkërenduara për çështje të ndryshme të veprimtarive dhe kompetencave të Aleancës (e ashtuquajtura “*acquis*” politike e NATO-s);
2. Të jenë të përfshirë gjallërisht në proceset e këshillimit e të vendimmarrjes brenda Aleancës, duke punuar me vetëdije dret konsensusit;
3. Të miratojnë politikën e dyerve të hapura të Aleancës, që lidhet me nenin 10 të Traktatit të Washingtonit dhe Deklaratat që vijuan Mbedhjet e Nivelit të Lartë të Madridit, Washingtonit, Pragës dhe Stambollit;

4. Të bëhen pale në marrëveshjet e protokollët shumëpalësh që janë miratuar ndërmjet shteteve anëtarë;
5. Të venë në zbatim mënyrën e gjerë të trajtimit të sigurisë të theksuar në Konceptin Strategjik të NATO-s;
6. Të marrin pjesë gjallërisht në strukturën ushtarake të integruar dhe në planifikimin e mbrojtjes së përbashkët si dhe të ofrojnë forca e aftësi për të gjitha llojet e misionëve të Aleancës;
7. Të caktojnë një shumë të drejtë të burimeve të buxhetit për vënien në zbatim të këtyre zotimeve, si dhe të marrin pjesë në buxhetet e NATO-s të financuara në mënyrë të përbashkët.

Anëtarësimi në NATO i sjell padyshim përfitime praktike vendit. Të gjithë vendet anëtarë kanë të njëjtat vlera për lirinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe sipërmarrjen private.

Në **anën politike**, anëtarësimi në NATO bën të mundur edhe pjesëmarrjen e barabartë në proceset ndërkombëtare dhe në vendimmarrjen për çështje të rëndësishme, çka i lejon çdo vendi anëtar të lartësojë interesat e saj kombëtarë në rrethana ndërkombëtare si dhe të marrë pjesë në çështje me rëndësi vendimtare për sigurinë e vendit e të rajonit.

Anëtarësimi në NATO ka ndikim pozitiv edhe në procesin e integritimit në BE po ashtu si reformat që kryhen në procesin e anëtarësimit në NATO janë pjesë përbërëse e plotësimit të kriterëve të BE-së. Gjithashtu, të dyja këto organizata kanë vlera dhe objektiva të përbashkët si dhe bashkëpunojnë për anë të veçanta të sigurisë.

Duke u shprehur me **terma politiko-ushtarakë**, anëtarësimi në NATO është garancia më e mirë e mundëshme e sigurisë kombëtare. Të kundërpërgjigjesh me aftësitë e duhura dhe në mënyrë të përbashkët në raste emergjencash është parakusht dhe mjet në rrugën drejt ndërtimit të forcave të armatosura moderne e të pajisura siç duhet.

Nga **këndvështrimi ekonomik**, anëtarësia e plotë në Aleancë sjell përfitime të drejtpërdrejta e të tërthortë. Siguria si parakusht i zhvillimit ekonomik ndihmon për krijimin e besimit për investitorët e huaj, partnered tregëtarë e turistët, të cilët nga ana e tyre kanë ndikim mbi rritjen e mundësive për vende pune erritje të pagave.

Së fundi, vetë NATO krijon mundësi ekonomike. Si pjesë e programeve për infrastrukturën e pajisjet e sigurisë të financuara në mënyrë të përbashkët, vendet e ndryshëm mund të marrin mbështetje të madhe në modernizimin ose ndërtimin e infrastrukturës e të pajisjeve të tilla si aeroportet, sistemet e komunikimit e të

informacionit, radarët, sistemet e lundrimit, etj. Vendet e ndryshëm kanë mundësi për standarde më të lartë në teknologjinë ushtarake si dhe mundësi më të larmishme për pjesëmarrjen e shkencëtarëve bullgarë në institute kërkimore të huaj dhe për përfshirje të përbashkët në projekte të financuar nga NATO ose të zbatuar në mënyrë të përbashkët me shtete të tjerë anëtarë.

PASTHËNIE:

NATO është padyshim organizata moderne më e frytëshme në çështjet e sigurisë. Kyçi për suksesin e Aleancës mbështetet në parimet e vlerat mbi të cilat është zhvilluar. Në rrethanat e natyrës së ndryshueshme të kërcënimeve dhe të ndryshimit të përparësive të sigurisë, ato vlera të demokracisë, respekti për të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit janë në të vërtetë idealet që bashkojnë shtetet anëtarë.

Fuqia e NATO-s i ka rrënjët në aftësinë e saj për të ndryshuar, për t' a ndryshuar vetveten me qëllim që t' u kundërpërgjigjet kërcënimeve të rinj asimetrikë, terrorizmit ndërkombëtar dhe përhapjes së armëve të shkatërrimit masiv. Duke mbajtur parasysh rolin kufizues e mbrojtës, NATO është garancia për sigurinë kombëtare të anëtarëve të saj. Nëpërmjet politikës së saj të dyerve të hapura, Aleanca përpiqet që të bashkërendojë përpjekjet e saj me anëtarët e rinj të cilët kanë në thelb të njejtat vlera Euroatlantike. Duke u përqendruar në marrëdhëniet prej partneri përtej hapësirës Euroatlantike, d.m.th., në vendet e pellgut Mesdhetar, Kaukazin e jugut, Azinë Qendrore dhe Lindjen e mesme të Zgjeruar, NATO shfaq vendosmërinë e saj për të vepruar si një organizatë e cila është e gatëshme dhe e aftë të marrë përgjegjësi e të përballet me sfida që lidhen me kërcënimet bashkëkohorë të sigurisë dhe e cila synon në parandalimin e konflikteve e mirëkujdesjen e zhdërvjellët për krizat.

Dinamika e mjedisit të sigurisë e detyron NATO-n që të ndryshojë e të kërkojë barazpeshën ndërmjet misioneve të saj tradicionalë e kërcënimeve të rinj botërorë, të ofrojë aftësi ushtarake të shpejta e të zhdërvjellta, të përshtatë vetveten që t' u përgjigjet kërkesave të anëtarëve të saj për më shumë siguri e qendrueshmëri e në këtë mënyrë të veprojë me sukses brenda e jashtë hapësirës Euroatlantike të përgjegjesisë. Për këtë arsye, sot, ne mund t' a quajmë **NATO-n një organizatë rajonale me përgjegjësi botërore.**

ANEKSE

Traktati i Atlantikut Verior

Washington D.C. – 4 prill 1949

Palët nënshkruese të këtij Traktati ripohojnë besimin e tyre në qëllimet e parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuar dhe dëshirën e tyre për të jetuar në paqe me të gjithë popujt e qeveritë.

Ata janë të vendosur që të mbrojnë lirinë, trashëgiminë e përbashkët dhe qytetërimin e popujve të tyre, të mbështetur në parimet e demokracisë, lirisë vetiake e sundimit të ligjit.

Ata kërkojnë të lartësojnë qendrueshmërinë e mirëqenien e hapësirës Euroatlantike.

Ata janë të vendosur që të bashkojnë përpjekjet e tyre për mbrojtje të përbashkët dhe për ruajtjen e paqes e sigurisë.

Për këto arsye, ata janë marrë vesh për këtë Traktat të Atlantikut të Veriut:

Neni 1

Palët marrin përsipër, siç është përcaktuar në Kartën e Kombeve të Bashkuar, që të zgjidhin çdo mosmarrëveshje ndërkombëtare në të cilën ata mund të përfshihen me mjete paqësore në një mënyrë të tillë që paqa, siguria e drejtësia të mos rrezikohen si dhe të përmbahen në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare prej kërcënimit të përdorimit ose përdorimit të forces në çfarëdo mënyre e cila nuk përputhet me synimet e Kombeve të Bashkuar.

Neni 2

Palët do të ndihmojnë për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndërkombëtare paqësore e miqësore nëpërmjet forcimit të institucioneve të tyre të lire, krijimit të një kuptimi të të mire për parimet mbi të cilat janë themeluar këta institucione dhe lartësimit të kushteve të qendrueshmërisë e mirëqenies. Ata do të mundohen të shmangin konfliktet në politikat e tyre ekonomike ndërkombëtare dhe do të nxitin bashkëpunimin ekonomik ndërmjet tyre ose të gjithëve.

Neni 3

Me qëllim që të arrihen në mënyrë më të frytëshme objektivat e këtij Traktati, Palët, veçmas e së bashku, nëpërmjet vetëndihmës e ndihmës së ndërsjelltë të vazhdueshme e të frytëshme, do të mbajnë e zhvillojnë aftësitë e tyre të veçanta e të përbashkëta për t'i kundërqëndruar një sulmi të armatosur.

Neni 4

Palët do të këshillohen së bashku kurdoherë që, sipas mendimit të secilit prej tyre, kërcënohet tërësia tokësore, pavarësia politike ose siguria e secilës prej Palëve.

Neni 5

Palët merren vesh që një sulm i armatosur kundër njëres ose më shumë prej tyre në Europë ose në Amerikën e Veriut do të vështrohet si sulm kundër të gjithave prej tyre dhe, si rrjedhojë, ata merren vesh që, nëse një sulm i tillë ndodh, secila prej tyre, në ushtrim të së drejtës për vetëmbrojtje vetiake ose të përbashkët të njohur nga Neni 51 i Kartës së Kombeve të Bashkuar, do të ndihmojë Palën ose Palët e sulmuara në mënyrë të tillë nëpërmjet ndërmarrjes së menjëherëshme të veprimeve vetiake ose në bashkërendim me Palët e tjera të tilla që gjykohen si të nevojshme, përfshirë përdorimin e forces së armatosur, për të rivendosur e ruajtur sigurinë e hapësirës së Atlantikut të Veriut.

Çdo sulm i armatosur i tillë dhe të gjitha masat e marra si rrjedhojë e tij do t'i njoftohen menjëherë Këshillit të Sigurisë. Të tilla masa do të ndërpriten në kohën kur Këshilli i Sigurisë të ketë marrë masat e nevojshme për rivendosjen e ruajtjen e paqes e sigurisë ndërkombëtare.

Neni 6

Në lidhje me synimin e Nenit 5, një sulm i armatosur mbi një ose më shumë prej palëve mendohet se përfshin një sulm të armatosur:

- mbi territorin e secilës prej palëve në Europë e në Amerikën e Veriut, mbi Departamentet Algjeriane të Francës, mbi territorin e ose mbi Ishujt që ndodhen nën juridiksionin e secilës prej Palëve në hapësirën e Atlantikut të veriut në veri të Tropikut të Gaforres;
- mbi forcat, anijet ose avionët e secilës prej Palëve, kur në ose mbi këta territore ose në çdo hapësirë tjetër në Europë në të cilën forcat pushtuese të secilës prej Palëve kanë qenë të vendosura në ditën kur Traktati hyri në fuqi ose në Detin Mesdhe ose në hapësirën Atlantike të veriut në veri të Tropikut të gaforres.

Neni 7

Ky Traktat nuk ndikon dhe nuk duhet të interpretohet sikur ndikon në asnjë mënyrë mbi të drejtat e detyrimet që kanë Palët që janë anëtare të Kombeve të Bashkuar në përputhje me Kartën e OKB-së, ose mbi përgjegjësinë përparësore të Këshillit të Sigurisë për ruajtjen e paqes e sigurisë ndërkombëtare.

Neni 8

Secila Palë deklaron se asnjë prej zotimeve të saj ndërkombëtare që janë tani në fuqi ndërmjet saj e çdo Pale tjetër ose një shteti të tretë nuk është në kundërshtim me nenet e këtij Traktati dhe merr përsipër që të mos bëhet pjesë e asnjë zotimi ndërkombëtar që është në kundërshtim me këtë Traktat.

Neni 9

Palët nëpërmjet këtij Traktati krijojnë një Këshill, në të cilin do të përfaqsohet secili prej tyre, për të shqyrtuar çështje që lidhen me zbatimin e këtij Traktati. Ky

Këshill do të organizohet në mënyrë të tillë që të jetë i aftë të mblidhet menjëherë në çdo kohë. Ky Këshill do të krijojë organizma ndihmës sipas nevojave; në mënyrë të veçantë ai do të krijojë menjëherë një komitet të mbrojtjes i cili do të këshillojë masa për zbatimin e Neneve 3 dhe 5.

Neni 10

Palët mund që, me marrëveshje të njëzëshme, të ftojnë për t'u bërë pale e këtij Traktati çdo shtet tjetër europian që është i aftë të mbështetë parimet e këtij Traktati e të ndihmojë për sigurinë e hapësirës së Atlantikut të veriut. Çdo shtet që që ftohet në mënyrë të tillë mund të bëhet Palë e këtij Traktati nëpërmjet vendosjes së instrumentit të anëtarësimit pranë Qeverinë e Shteteve të Bashkuar të Amerikës. Qeveria e Shteteve të Bashkuar të Amerikës do të informojë secilën prej Palëve për një vendosje të tillë të çdo instrumenti të anëtarësimit.

Neni 11

Ky Traktat do të ratifikohet dhe nenet e tij do të zbatohen nga Palët në përputhje me proceset e tyre kushtetuese përkatëse. Instrumentët e ratifikimit do të vendosen sa më shpejt që të jetë e mundur pranë Qeverisë së Shteteve të bashkuar të Amerikës, e cila do të mbajë shënim të gjithë nënshkruarit e tjerë për çdo vendosje. Ky Traktat do të hyjë në fuqi ndërmjet Shteteve të cilët e kanë ratifikuar atë sapo ratifikimet e shumicës së nënshkruarëve, përfshirë ratifikimet e Belgjikës, Kanadasë, Francës, Luksemburgut, Holandës, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuar, të jenë vendosur kurse për shtetet e tjerë do të veprojë ditën e vendosjes së ratifikimeve të tyre.

Neni 12

Pasi ky Traktat të ketë qenë në fuqi për dhjetë vjet, ose në çdo kohë tjetër më pas, Palët do të, nëse atyre u kërkohet, këshillohen së bashku për rishikimin e Traktatit, duke mbajtur parasysh faktorët që kanë ndikuar më pas në paqen e sigurinë e hapësirës së Atlantikut të veriut, përfshirë krijimin e marrëveshjeve të reja të përgjithëshme ose rajonale në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuar për ruajtjen e paqes e sigurisë ndërkombëtare.

Neni 13

Pasi ky Traktat të ketë qenë në fuqi për njëzet vjet, secila Palë mund të pushojë së qeni Palë një vit pasi i ka paraqitur me shkrim shkëputjen e saj Qeverisë së Shteteve të Bashkuar të Amerikës, e cila do të njoftojë Qeveritë e Palëve të tjera për paraqitjen e çdo shkresë për shkëputje.

Neni 14

Ky Traktat, tekstet në anglisht e në frëngjisht të të cilit janë njëlloj të saktë, do të vendoset në arkivat e Qeverisë së Shteteve të Bashkuar të Amerikës. Kjo Qeveri do t'u japë kopje të çertifikuara siç duhet Qeverive të nënshkruarëve të tjerë.

NATO në Akronime

ACO - Operacionet e Komandës së Bashkuar (pjesë e strukturës ushtarake të NATO-s)

Althea – mision ushtarak i Bashkimit European që mori komandën e stabilizimit në Bosnje e Hercegovinë në vitin 2004, misionin SFOR të NATO-s

ATA – Shoqata e Traktatit të Atlantikut – një organizatë joqeveritare ndërkombëtare, e krijuar në vitin 1954 nga shtete anëtarë të NATO-s

AWACS – Sistemi i Kontrolleve dhe Paralajmërimit Ajror (një sistem mbikqyrjeje shumë i lëvizshëm i projektuar për të krijuar një sistem të fuqishëm mbrojtjeje ajrore mbi të gjithë hapësirën Euroatlantike)

Berlin Plus Arrangements – të miratuara në maj të vitit 2003 në lidhje me bashkëpunimin me BE-në, sipa të cilave burimet e aftësitë e NATO-s mund të përdoren në misionet e udhëhequr nga BE)

CBRN - Armët Kimike, Biologjike, Radiologjike e Bërthamore; një Batalion Shumëkombësh (ku përfshiheshin 13 shtete anëtarë) kundër CBRN u krijua në dhjetor të vitit 2003, si një pjesë përbërëse e Forcës së Kundërpërgjigjes së Shpejtë të NATO-s (NRF)

CFSP – Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë e BE-së; nëpërmjet Traktatit të Bashkimit European të nënshkruar në Maastricht e të hyrë në fuqi në vitin 1993; atë u morën vesh që t'a krijojnë anëtarët e BE-së

CIMIC – Bashkëpunimi Civil-Ushtarak i cili ka rol të rëndësishëm për mirëkujdesjen për krizat

CIS – Komuniteti i Shteteve të Pavarur, themeluar në dhjetor të vitit 1991, pas shpërbërjes së ish BRSS-së

CMC – Kryetari i Komitetit Ushtarak (pjesë e strukturës ushtarake të NATO-s)

DPC – Komiteti i Planifikimit të Mbrojtjes, pjesë e strukturës politike të NATO-s, merret me çështje të mbrojtjes së përbashkët

EADRCC – Qendra Euroatlantike e Bashkërendimit të Kundërpërgjigjes ndaj Fatkeqësive (e krijuar në vitin 1998 në Venndodhjen Qendrore të NATO-s)

EAPC - Këshilli i Partneritetit Euroatlantik (një këshill i vendeve partnere të NATO-s), i krijuar në vitin 1997, zëvendësues i NACC-it për fillimin e një faze të re të bashkëpunimit euroatlantik

EC – Komuniteti European/ Komunitetet Europiane

EU – Bashkimi European

HQ – Vendndodhje Qendrore, Vendndodhja Qendrore e NATO-s është në Bruksel. Ajo është selia e përhershme e Këshillit të Atlantikut të Veriut (NAC)

ICI – Nisma e Bashkëpunimit e Stambollit, e filluar në Mbledhjen e Nivelit të lartë të NATO-s të Stambollit të vitit 2004 e cila kishte synimin e zhvillimit të sigurisë e qendrueshmërisë rajonale si dhe nxitjen e bashkëpunimit mbi themele dypalëshe me vendet e interesuar në Lindjen e Mesme të Zgjeruar (Këshilli i Bashkëpunimit i Gjirit Persik); nismë plotësuese e Dialogut të Mesdheut

IFOR – Forca e Zbatimit – forca shumëkombëshe të vendosura nga NATO në Bosnjë e Hercegovinë me mandatin e OKB-së për zbatimin e Marrëveshjes së Dayton-it (1992-1995, e zëvendësuar nga SFOR-i në vitin 1996

IS – Shtabi Ndërkombëtar në Vendndodhjen Qendrore të NATO-s, mbështet Këshillin e Atlantikut të veriut dhe komitetet që janë në varësinë e tij në ushtrimin e detyrave të tyre

ISAF – Forcat Ndërkombëtare të Sigurisë në Afganistan – forca ndërkombëtare nën emblemën e OKB-së të krijuara në vitin 2001

KFOR – Forca e NATO-s për Kosovën, e vendosur me mandatin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurisë të OKB-së të 10 qershorit 1999 për parandalimin e shpërthimit të konfliktit

MAP – Plani i Veprimit për Anëtarësim, i miratuar në vitin 1999, përfshin hapa konkretë për vendet candidate të NATO-s

MCG – Grupi i Bashkëpunimit i Mesdheut – përgjegjës për zhvillimin e nismë së Dialogut të Mesdheut (Algjeria, Egjipti, Izraeli, Jordania, Mauritania, Maroku dhe Tunizia)

Mediterranean Dialogue – Forum i krijuar në vitin 1995 me 7 vende rajonale për të ndihmuar për sigurinë e qendrueshmërinë e Mesdheut dhe për arritjen e një kuptimi më të mire të ndërsjellët e të një bashkëpunimi më të afërt

NAC – Këshilli i Atlantikut të Veriut (pjesë e strukturës politike të NATO-s) ku mblihdhen rregullisht përfaqësues të çdo shteti anëtar. Njësia më e rëndësishme e NATO-s për vendimmarrjen

NACC – Këshilli i Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut, pjesë e institucionalizimit të marrëdhënieve të Aleancës me vendet e Europës Qendrore e lindore. Bulgaria është një vend themelues. Mbledhja e parë e këtij Këshilli u bë në dhjetor të vitit 1991, në të cilën u miratua *Deklarata për Dialog, Partneritet dhe Bashkëpunim*

NATO – Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut, e krijuar në vitin 1949 nëpërmjet nënshkrimit të Traktatit të Washingtonit që nxiste mbrojtjen e përbashkët

NPG – Grupi i Planifikimit Bërthamor – pjesë e strukturës politike të NATO-s; ai merret me një tërësi të gjerë çështjesh politike që lidhen me politikën bërthamore

NPPA – Programi Kombëtar për Përgatitjen për Anëtarësim në NATO

NRC – Këshilli NATO – Rusi, i krijuar në vitin 2002 si një forum i ri për bashkëpunim, mjet për këshillime, krijim konsensusi dhe marrje vendimesh e veprimesh të përbashkët, duke bashkëpunuar nga vendndodhje të barabarta

NRF – Forca e Kundërpërgjigjes së shpejtë të NATO-s, nismë e krijuar në Mbledhjen e Nivelit të Lartë të NATO-s në Pragë në vitin 2002 për shndërrimin ushtarak që

synonte të krijonte forca tokësore, ajrore e detare të gatëshme për t'u vendosur brenda më pak se 5 ditëve. Veprueshmëria e tyre e plotë duhet të arrihet jo më vonë se tetori i vitit 2006

NSIP – Programi i Investimit për Sigurinë i NATO-s

NTM – Misioni i NATO-s në Irak, i mbështetur në rezolutën 1546 të Këshillit të Sigurisë të OKB-së me synimin kryesor për të bërë shtetvite të forcave të armatosura e të personelit të sigurisë të shtetit të Irakut; ai nuk ka karakter ushtarak në thelbin e tij

NUC – Komisioni NATO – Ukrainë, i krijuar në vitin 1997 si një organizëm përfaqësues i bashkëpunimit të vendosur, të miratuar sipas kartës së Partneritetit të Veçantë

OSCE/CSCE – Organizata për Siguri e Bashkëpunim në Europë, e krijuar si Konferenca për Siguri e Bashkëpunim në Europë në Helsinki në vitin 1975

PCC – Zotimi i Aftësive i Pragës i vitit 2002 ku aleatët e veçantë të NATO-s morën zotime të veçantë politikë për përmirësimin e zhvillimin e aftësive të tyre mbrojtëse kombëtare në një larmi të gjerë fushash

PfP – Partneriteti për paqe – një nismë për rritjen e sigurisë e qendrueshmërisë në të gjithë Europën e miratuar në Mbledhjen e Nivelit të Lartë të NATO-s të Brukselit të vitit 1994. atje u ftuan për të marrë pjesë vendet partnere të NACC-it dhe vendet anëtarë të CSCE-së, ose OSCE-së së ardhëshme. Tani, ka 27 vende partnerë

PJC NATO – Russia – Këshilli i Përbashkët i Përhershëm, i themeluar në vitin 1997 si forum për këshillime të rregullt mbi çështjet e sigurisë dhe i zëvendësuar në vitin 2002 nga Këshilli NATO - Rusi

PRIs – Ekipi Rajonal – struktura civile-ushtarake të NATO-s në Afganistan

SACEUR – Komandanti Suprem i Forcave Aleate në Europë (një prej komandave ushtarake të NATO-s) vendndodhja e të cilit është në Mons të Belgjikës; është përgjegjës për të gjithë operacionet e NATO-s në tokë; është Kreu i Komandës Europiane të Sh.B.A.-së

SACLANT – Komandanti Suprem i Forcave Aleate të Atlantikut – ish komanda ushtrake e NATO-s deri sa u bë racionalizimi i strukturës së komandës së Aleancës në Mbledhjen e Nivelit të Lartë të Pragës të vitit 2002

SACT – Komanda e Supreme e Forcave Aleate për Shndërrimin (një prej komandave ushtarake të NATO-s) e cila e ka vendndodhjen në Norfolk të shtetit Virginia të Sh.B.A.-së e cila ka para së gjithash rol veprues meqenëse ajo është e ngarkuar për procesin e shndërrimit të aftësive ushtarake të Aleancës, është gjithashtu edhe Komandë e forcave të bashkuara të Sh.B.A.-së

SFOR – Forca e Qendrueshmërisë (në vend të IFOR-it, 1996-04), misioni i NATO-s në Bosnjë e Hercegovinë deri në vitin 2004 i cili u zëvendësua nga operacioni i udhëhequr nga BE, **Althea**

Sec Gen – Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s i cili është një zyrtar i lartë ndërkombëtar i emërua nga shtetet anëtarë

SOFA – Marrëveshje për Statusin e Forcave si pjesë e Partneritetit për Paqe të nënshkruar në vitin 2005 i cili rregullon veprimet e përbashkët ndërmjet NATO-s e Ruisë për të trajtuar sfidat e përbashkëta të sigurisë

UN – Kombet e Bashkuar, e krijuar në vitin 1945 në San Francisko nga 51 vende themeluese për të ruajtur paqen e sigurinë ndërkombëtare dhe për të zhvilluar marrëdhënie miqësore ndërmjet kombeve. Tani vendet e saj anëtarë janë 191. Bullgaria u bë anëtare e Kombeve të Bashkuar në vitin 1955

UNMIK – Misioni i Kombeve të Bashkuar në Kosovë, i krijuar në vitin 1999 mbështetur në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurisë të OKB-së

UNSC – Këshilli i Sigurisë i Kombeve të Bashkuar, organizmi kryesor vendimmarrës i OKB-së. Bullgaria ka qenë anëtare jo e përherëshme Këshillit të Sigurisë në periudhën 2002-2004. Republika e Kinës, Franca, Federata Ruse, Mbretëria e Bashkuar dhe Sh.B.A. janë anëtarë të përhershëm të Këshillit të Sigurisë dhe kanë të drejtën e vetos

USSR – Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike

WEU – Bashkimi Europian Perëndimor; i krijuar si organizatë ushtarake nga Traktati i Brukselit në vitin 1948. në vitin 1954 Pakti i Brukselit u rishikua dhe krijoji WEU. Tani, pjesë e strukturave të BE-së

WMD – Armët e Shkatërrimit Masiv

NATO
në bashkëpunim me organizata të tjera ndërkombëtare

Kombet e Bashkuar

OSBE

NATO

Belarusi	Monako	Turkmenistani
Kazakistani	Selia e Shenjtë	Uzbekistani
Republika Kirgize	Taxhikistani	
Canadaja	Sh. B. A.	

Bashkimi European

Republika Çeke	Hungaria	Malta
Denimarka	Letonia	Polonia
Estonia	Lituania	Qipro
		Sillovakia
		Silovenia

- Armenia
- Azerbajxhani
- Gjeorgjia
- Kroacia
- Moldova
- Republika e Maqedonisë
- Rusia
- Shqipëria
- Ukraina
- Zvicra

Bashkimi European Perëndimor

Belçika	Holanda	Portugalia
France	Italia	Spanja
Gjermania	Luksemburgu	
Greqia	Mbretëria e Bashkuar	

- Austria
- Finlanda
- Irlanda
- Suedia

Bullgaria	Norvegjia	Turqia
Islanda	Rumania	

Andorra	Lihtenshtejni	Serbia
Bosnia e Hercegovina	San Marino	

Këshilli i Europës

**Këshilli i Partneritetit
Euroatlantik**

Armenia	Irlanda	Shqipëria
Austria	Kazakistani	Suedia
Azerbajxhani	Republika Kirgize	Taxhikistani
Belarusi	Kroacia	Turkmenistani
Finlanda	Republika e Maqedonisë	Uzbekistani
Gjeorgjia	Moldova	Zvicra

Këshilli NATO - Russi

Rusia

Komisioni NATO - Ukrainë

Ukraina

NATO

Belgjika	Hungaria	Portugalia
Bullgaria	Islanda	Polonia
Republika Çeke	Italia	Rumania
Danimarka	Kanadaja	Sh. B. A.
Estonia	Letonia	Slllovenia
Franca	Lituania	Slllovakia
Gjermania	Luksemburgu	Spanja
Greqia	Norvegjia	Turqia
Holanda	Mbretëria e Bashkuar	


Arabia
Saudi
Bahreini
Emiratet e
Bashkuara
Arabe
Katari
Kuvajti
Oman

**Këshilli i
Bashkëpunimit
të Gjirit Persik**

Alegjeria	Mauritania
Egjipti	Maroku
Izraeli	Tunizia
Jordania	

**Grupi i
Bashkëpunimit të
Mesdheut**

STRUKTURA POLITIKE



STRUCTURA CIVILE E USHTARAKE

